



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/6
Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 555, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË, TË DISA KLASAVE TË ARSIMIT BAZË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrin nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Matematikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Dituri natyre”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
5. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Edukim fizik, sport dhe shëndet”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës bërthamë, për klasën e pestë, klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit bazë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë shqipe", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë angleze", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës "Qytetari", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 17, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
18. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë (frënge, italiane, gjermane), për shkollat me marrëveshje me ambasadat", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 18, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
19. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 19, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

20. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Muzikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 20, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
21. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Art pamor”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 21, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
22. Programet mësimore të klasës së parë dhe klasës së gjashtë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
23. Programet mësimore të klasës së shtatë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
24. Programi mësimor i klasës së pestë hyn në fuqi dhe fillon zbatimin në vitin shkollor 2029 – 2030.
25. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.
26. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “GJUHË SHQIPE” ARSIMI I MESËM I ULËT KLASA 6

FUSHA “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”

PROGRAM I PËRDITËSUAR

Koordinatore: Erida Koleci



PËRMBAJTJA

I. HYRJE	4
II. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM TË LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE	5
2.1. Qëllimet e lëndës	5
2.2. Lënda e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët	6
2.3. Objektivat e përgjithshëm të lëndës së gjuhës shqipe.....	7
III. STRUKTURA E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE	8
IV. KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E GJUHËS SHQIPE	10
4.1. Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit	10
4.2. Integrimi i temave ndërkurrikulare në lëndën e gjuhës shqipe.....	15
4.3. Kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe.....	17
V. PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	22
5.1. Koha mësimore për secilën kompetencë për klasën e gjashtë.....	23
5.2. Përmbajtja mësimore e klasës së gjashtë	24
<i>Të lexuarit e teksteve letrare</i>	30
<i>Të lexuarit e teksteve joletrare</i>	33
5.3. Shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).....	45

VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES.....	47
6.1. Metodatat dhe teknikat mësimore për zhvillimin e kompetencave gjuhësore.....	49
6.2. Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e gjuhës shqipe	51
6.3. Bisedat letrare	53
6.4. Lexuesi i shekullit XXI.....	53
6.5. Puna me nxënësit me aftësi të kufizuara në lëndën e gjuhës shqipe.....	55
6.6. Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjuhës shqipe	56
VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE.....	57
7.1. Parimet e vlerësimit në lëndën e gjuhës shqipe	57
7.2. Llojet e vlerësimit në lëndën e gjuhës shqipe	58
7.3. Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të nxënësit.....	64
VIII.BURIMET DHE MATERIALET MËSIMORE.....	65
8.1. Përdorimi i teknologjisë në lëndën e gjuhës shqipe.....	66
8.2. Roli i bibliotekës së shkollës	67
IX. REKOMANDIME PËR ZBATUESIT E PROGRAMIT	68

I. HYRJE

Gjuha është themeli i të menduarit, i komunikimit dhe i mësimi. Ajo shërben si mjeti kryesor për të kuptuar botën, për të ndarë ide dhe për të ndërtuar marrëdhënie me veten dhe me të tjerët. Përmes gjuhës, individët dhe kombet lidhin të kaluarën me të tashmen dhe të ardhmen, duke ruajtur dhe përcjellë vlerat, traditat dhe historinë e tyre brez pas brezi. Gjuha forcon vetëdijen kombëtare, duke nxitur edhe ndjenjën e përkatësisë dhe krenarisë për kulturën dhe historinë e kombit. Gjithashtu, gjuha ka një rol të veçantë në jetën shoqërore dhe institucionale të një vendi. Ajo përdoret në ligje, në administratën publike, në arsim, në komunikimin zyrtar etj., duke krijuar një bazë të përbashkët për bashkëpunim dhe mirëkuptim. Njohja dhe përdorimi i saktë i gjuhës janë parësorë për ndërtimin e një shoqërie të informuar dhe të angazhuar, ku qytetarët janë të aftë të komunikojnë me qartësi dhe të marrin pjesë aktive në jetën kulturore, sociale dhe politike të vendit të tyre. Për këto arsye, mësimi i gjuhës zyrtare është një nga detyrat kryesore të arsimit parauniversitar, pasi nëpërmjet saj kontribuohet në zhvillimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe të ndërgjegjshme. Në këtë kontekst, programi i gjuhës shqipe synon t'u japë nxënësve njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të komunikuar me qartësi e efektivitet dhe për të kuptuar me thellësi tekstet e shkruara dhe të folura.

Ky program ndërton bazat për zhvillimin e të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit në mënyrë të integruar. Ai inkurajon nxënësit të eksplorojnë një gamë të gjerë tekstesh, duke përfshirë prozë, dramë, poezi, tekste joletrare dhe materiale multimediale, për të pasuruar kuptimin e tyre për gjuhën. Programi synon të kultivojë dashuri për të lexuarit dhe të shkruarit, duke nxitur kureshtjen, kreativitetin dhe aftësinë për vetëshprehje. Përmes këtij programi, nxënësit kanë mundësinë të zhvillojnë identitetin personal dhe kombëtar, duke njohur dhe duke vlerësuar gjuhën dhe letërsinë shqipe, si dhe diversitetin e përvojave dhe të shprehjeve njerëzore.

Ky program promovon gjithashtu aftësinë për të menduar në mënyrë kritike dhe për të analizuar tekstet nga perspektiva të ndryshme, duke i ndihmuar nxënësit të dallojnë informacionin e vërtetë dhe ai i rremë, të bëjnë lidhje të thella mes njohurive dhe përvojave personale dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre për të komunikuar në mënyrë të vetëdijshme dhe të qëllimshme. Përmes këtij procesi, nxënësit bëhen të hapur ndaj ideve të reja dhe perspektivave të ndryshme, duke zhvilluar një ndjenjë të përbashkët qytetarie dhe përgjegjësie globale.

Me këtë qasje, programi i gjuhës shqipe synon të zhvillojë nxënës të sigurt, të motivuar dhe të përgatitur për të përballuar sfidat e kohës, duke i pajisur ata me kompetencat e nevojshme për të qenë aktivë dhe të përfshirë në një shoqëri globale dhe në ndryshim.

II. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM TË LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE

2.1. Qëllimet e lëndës

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesën në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Ajo zhvillohet nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë, dhe qëllimet e saj janë:

- Përdorimi i gjuhës në mënyrë korrekte, të përshtatshme dhe të përgjegjshme në kontekste dhe për qëllime të ndryshme.
- Njohja dhe vlerësimi i trashëgimisë letrare shqipe dhe botërore, nëpërmjet analizës së veprave letrare, gjinive, gjuhës dhe stilit të tyre, kontekstit historiko-kulturor, si dhe ndërtimit të një qëndrimi personal kritik dhe estetik ndaj letërsisë.
- Zhvillimi i të menduarit kritik dhe krijues nëpërmjet aftësimit për të përdorur, për të analizuar, për të interpretuar dhe për të vlerësuar informacione në mënyrë etike nga burime të ndryshme, aftësimit për të argumentuar mendimet e qëndrimet në mënyrë të strukturuar e logjike dhe aftësimit për të krijuar (hartuar) tekste të ndryshme.
- Ndërtimi i njohurive dhe i aftësive për strukturën dhe regjistrat e ndryshëm të gjuhës, mjetet shprehëse në letërsi dhe në tekstet joletrare.
- Zhvillimi i aftësive për t’u shprehur në mënyrë të saktë dhe të qartë si me shkrim ashtu edhe me gojë, duke njohur dhe duke zbatuar rregullat e sistemit gjuhësor të shqipes.
- Zhvillimi i identitetit kombëtar përmes njohjes dhe studimit të gjuhës dhe të letërsisë shqipe.

2.2. Lënda e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët

Në arsimin fillor, nxënësit kanë përvetësuar njohuri dhe aftësi bazë për gjuhën. Përveç larmisë së pasur të njohurive gjuhësore që sjellin nga familja, ata kanë zhvilluar një gamë aftësish dhe strategjish që mund t'i përdorin për të analizuar, për të vlerësuar dhe për të krijuar tekste gojore, të shkruara dhe mediatike gjithnjë e më komplekse. Ata kanë zhvilluar gjithashtu aftësinë për të reflektuar mbi të nxënit e tyre, për ta ndjekur atë dhe për të ndërmarrë hapa për përmirësimin e njohurive dhe të aftësive gjuhësore në të gjitha fushat e të nxënit.

Pritshmëritë në arsimin e mesëm të ulët ndërtohen mbi këtë themel. Nxënësit e klasave 6-9 konsolidojnë dhe zbatojnë njohuritë, aftësitë dhe strategjitë e tyre gjuhësore në të gjitha lëndët e kurrikulës, në një kohë kur përmbajtja mësimore bëhet gjithnjë e më sfiduese. Meqenëse niveli i njohurive, aftësive dhe strategjive gjuhësore ndryshon nga një nxënës tek tjetri, është e rëndësishme që mësimdhënia të jetë e diferencuar për t'iu përgjigjur nevojave të nxënësve dhe grupeve të vogla, përfshirë ata që kanë nevojë për më shumë kohë ose mbështetje për të përvetësuar njohuritë themelore gjuhësore. Kurrikula e gjuhës shqipe për klasat 6-9 është hartuar për t'i angazhuar nxënësit në detyra që ata i shohin si domethënëse, me qëllim që të motivohen të analizojnë, të vlerësojnë dhe të krijojnë tekste, jo vetëm për të përmbushur qëllimet e programit, por dhe interesat vetjakë.

Në arsimin e mesëm të ulët, mësuesit kanë rol kyç për të mësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe për të modeluar përdorimin e njohurive, aftësive dhe strategjive gjuhësore. Zhvillimi i aftësive të të folurit, që nuk është vetëm një përbërës i rëndësishëm i kurrikulës së gjuhës shqipe, duhet të jetë i pranishëm në çdo orë mësimore. Mësimdhënia cilësore u krijon mundësi nxënësve që të identifikojnë aftësitë dhe strategjitë që u nevojiten për t'u bërë përdorues të zotë të gjuhës në një shumëllojshmëri kontekstesh dhe të ecin drejt përmbushjes së qëllimeve të programit.

Qëllimi kryesor i lëndës është që nxënësit të arrijnë një nivel më të lartë pavarësie si përdorues të gjuhës shqipe. Për këtë është e rëndësishme që nxënësit të kenë qasje në një gamë të gjerë tekstesh që janë të lidhura me përvojat dhe interesat e tyre. Të gjitha tekstet e përzgjedhura për qëllime mësimore duhet të kenë vlerë përmbajtjesore, kombëtare dhe të promovojnë vlerat e shoqërisë njerëzore. Niveli i vështirësisë që paraqet një tekst, ndryshon nga një nxënës tek tjetri, pasi secili sjell në përballje me tekstin përvoja, këndvështrime dhe sfond unik. Për këtë arsye, është e domosdoshme që nxënësit e këtij niveli arsimor të kenë qasje në tekste që janë të ndryshme për nga gjatësia dhe forma, si dhe që përfshijnë tema,

subjekte, ide dhe informacione të larmishme, struktura të ndryshme organizimi dhe veçori të ndryshme. Kjo shumëllojshmëri duhet të jetë e mjaftueshme për t'i nxitur nxënësit të përdorin strategji të ndryshme për të kuptuar dhe për të analizuar fjalorin, subjektin apo temën e tekstit. Të gjithë nxënësit, veçanërisht adoleshentët, duhet të shohin veten e tyre të përfaqësuar në tekstet me të cilat ndërveprojnë. Gjithashtu, ata duhet të jenë në gjendje të zgjedhin në mënyrë të pavarur të lexojnë, të dëgjojnë ose të ndërveprojnë me tekste që kanë rëndësi personale për jetën e tyre të përditshme, përfshirë ato që trajtojnë çështje që lidhen me temat ndërkurrikulare.

Nxënësit e arsimit të mesëm të ulët duhet të kenë qasje në një gamë të gjerë tekstesh, përfshirë tekste gojore, tekste të shkruara, tekste mediatike dhe tekste digjitale. Si shkrues/krijues të teksteve gojore, të shkruara dhe mediatike, nxënësit e këtij niveli përdorin njohuritë, aftësitë dhe strategjitë gjuhësore për të kërkuar informacion, për të eksploruar ide, për të shprehur opinione dhe për të mbajtur qëndrime në të gjitha fushat e kurrikulës.

2.3. Objektivat e përgjithshëm të lëndës së gjuhës shqipe

Në arsimin e mesëm të ulët, nxënësi:


- dëgjon me vëmendje dhe kupton mesazhe në situata të ndryshme komunikimi, duke dalluar qëllimin, kontekstin dhe qëndrimin e folësit.
- flet në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe të strukturuar, duke përshtatur gjuhën sipas qëllimit, dëgjuesit dhe kontekstit, si dhe duke përdorur një fjalor të pasur.
- lexon, interpreton, analizon dhe vlerëson tekste të përshtatshme për moshën, tekste të shkruara e multimediale, tekste joletrare dhe tekste nga letërsia shqipe dhe botërore, duke zhvilluar mendimin kritik dhe shijen estetike.
- shkruan tekste të ndryshme (të vazhdueshme, të përziera dhe jolineare) për qëllime personale, mësimore e shoqërore, duke respektuar normat e drejtshkrimit dhe rregullat e ndërtimit të fjalisë.
- përdor njohuritë për sistemin gjuhësor të shqipes (fonetikën, morfologjinë, sintaksën, drejtshkrimin dhe leksikologjinë), duke ndërtuar tekste të sakta, koherente dhe të pasura në forma të ndryshme komunikimi.
- kërkon informacione nga burime të ndryshme, i përzgjedh dhe i vlerëson duke menduar në mënyrë kritike, njeh qëllimin e autorit dhe gjykon mbi besueshmërinë dhe vlerën e tyre.

- zhvillon identitetin gjuhësor dhe kombëtar përmes përdorimit të shqipes, vlerëson pasurinë e saj leksikore, njeh trashëgiminë kulturore e historike dhe ndërton botëkuptimin personal mbi vlera morale e estetike.

III. STRUKTURA E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE

Programi i gjuhës shqipe synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyç.

Në arsimin e mesëm të ulët, programi ka këto rubrika:



- *Qëllimet dhe objektivat e lëndës:* Në program përcaktohen qëllimet dhe objektivat e lëndës për arsimin e mesëm të ulët.
- *Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit:* Në program përcaktohet rëndësia e kompetencave kyç, si dhe janë pasqyruar rezultatet e të nxënit që zhvillohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe.
- *Temat ndërkurrikulare:* Në këtë rubrikë përcaktohet se çfarë janë temat ndërkurrikulare dhe janë dhënë disa shembuj që demonstrojnë mundësitë që ofron lënda e gjuhës shqipe për të integruar këto temat ndërkurrikulare, si: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; qytetaria aktive dhe sipërmarrja; shëndeti mendor e fizik dhe siguria; zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore; teknologjia, shoqëria dhe media.
- *Kompetencat e lëndës dhe rezultatet e të nxënit:* Në program përshkruhen kompetencat lëndore dhe janë dhënë rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë.
- *Përmbajtja mësimore:* Në këtë rubrikë përcaktohet koha mësimore për çdo klasë dhe është sugjeruar numri i orëve për çdo kompetencë. Gjithashtu është pasqyruar zbërthimi i rezultateve të të nxënit në njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime.
- *Metodologjia e mësimdhënies:* Në këtë rubrikë pasqyrohen parimet që duhet të udhëheqin mësuesit në zbatimin e programit, metodat dhe teknikat që mund të përdoren për të zhvilluar kompetencat kyç dhe lëndore, puna me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me nxënësit e talentuar, rëndësia e bisedave letrare ose e leximeve jashtë klase etj.
- *Vlerësimi i nxënësve:* Në këtë rubrikë përshkruhen në mënyrë të përmbledhur llojet e vlerësimit të nxënësit dhe disa shembuj të instrumenteve të vlerësimit. Gjithashtu jepen dhe shembuj të niveleve të arritjes së rezultateve të të nxënit.
- *Burimet dhe materialet mësimore:* Në program përcaktohen disa nga burimet e të nxënit që mund të përdoren gjatë procesit mësimor, roli i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, roli i bibliotekës së shkollës etj.
- *Rekomandime për zbatimin e programit:* Në këtë rubrikë jepen disa rekomandime për përdoruesit e programit lëndor, siç janë: mësuesit, hartuesit e teksteve shkollore, hartuesit e testeve kombëtare, vlerësuesit e jashtëm të cilësisë, prindërit dhe nxënësit.
- *Ndryshimet përmbajtjesore:* Në këtë rubrikë përshkruhen përditësimet kryesore në përmbajtjen lëndore, krahasuar me programin lëndor të mëparshëm.

IV. KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E GJUHËS SHQIPE

4.1. Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit

Gjatë viteve të ardhshme, nxënësit do të hyjnë në një treg pune që është rrënjësisht i ndryshëm nga ai që njohim sot. Me rritjen e automatizimit të punëve, përparimet e jashtëzakonshme teknologjike dhe realitetet e një ekonomie globale, nxënësit duhet të jenë të përgatitur për fleksibilitet në punë, orientim të shpeshtë të karrierës dhe për një jetë aktive profesionale dhe qytetare. Zhvillimi i kompetencave kyç dhe dëshira për të nxënë gjatë gjithë jetës do t'i ndihmojnë ata të përballen me këto realitete të reja dhe të formësojnë me sukses të ardhmen e tyre. *Kompetencat kyç janë një ndërthurje e njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve, të cilat mundësojnë që nxënësit të kenë sukses në botën e punës dhe të arrijnë rezultate të larta në të ardhmen.*

Në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar janë përcaktuar tetë kompetencat kyç që synohen të ndërtohen dhe të zhvillohen në arsimin parauniversitar. Këto kompetenca janë:

- Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare.
- Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja.
- Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri.
- Kompetenca digjitale.
- Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit.
- Kompetenca qytetare.
- Kompetenca e sipërmarrjes.
- Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore.

Kurrikula ofron mundësi për nxënësit të zhvillojnë kompetencat kyç në mënyra të përshtatshme për moshën dhe klasën gjatë gjithë viteve të shkollimit. Këto kompetenca zhvillohen jo të izoluara, por si pjesë e procesit mësimor në të gjitha lëndët e kurrikulës, përmes angazhimit konjitiv,

social, emocional dhe fizik të nxënësve në këtë proces. Mësuesit lehtësojnë zhvillimin e kompetencave kyç përmes metodave, teknikave dhe qasjeve të ndryshme të mësimdhënies dhe të vlerësimit, në një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë nxënësit.

Për të lehtësuar punën e mësuesit në zhvillimin dhe në vlerësimin e këtyre kompetencave, ato janë zbërthyer në rezultate të nxëni. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyç që mund të përmbushen nga nxënësi në klasën e gjashtë në lëndën e gjuhës shqipe, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në klasën e gjashtë

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i> - përshtat komunikimin e tij me kërkesat e situatës dhe me qëllimin; - dëgjon, lexon dhe shkruan tekste të thjeshta, përfshirë tekstet digjitale; - kërkon, mbledh dhe përpunon informacione duke përdorur mjete ndihmëse; - shpreh argumente me gojë dhe me shkrim në përshtatje me kontekstin; - përdor gjuhën për të krijuar krijime artistike, të cilat shprehin emocionet, përjetimet dhe idetë e tij; - merr pjesë në bashkëbisedime me moshatarët për tema me interes mësimor dhe shoqëror duke bërë pyetje, duke dhënë përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor;	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaja, nxënësi:</i> - kupton mjaftueshëm mesazhet gjatë një komunikimi kur flitet qartë dhe ngadalë; - lexon, kupton dhe shkruan tekste të thjeshta, përfshirë tekstet digjitale të përshtatshme për nevojat e tij; - përshkruan ose prezanton thjesht njerëzit, kushtet e jetesës, rutinën e përditshme; - merr pjesë në bashkëbisedime të thjeshta me moshatarët për tema me interes mësimor dhe shoqëror, duke bërë pyetje dhe duke dhënë përgjigje; - prezanton të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale; - prezanton para të tjerëve një projekt të thjeshtë për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup;

- prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup, duke integruar TIK-un; - përshkruan me gojë dhe me shkrim një ngjarje të lexuar ose të dëgjuar duke ruajtur rrjedhën logjike të saj; - identifikon dhe përdor burime të ndryshme informacioni për qëllime mësimore.	- përshkruan me gojë dhe me shkrim një ngjarje të lexuar ose të dëgjuar duke ruajtur rrjedhën logjike të saj; - identifikon dhe përdor disa burime informacioni për qëllime mësimore.
Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri	Kompetenca digjitale
<i>Për të dëshmuar kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi:</i> - zbaton proceset kryesore matematikore në kontekstet e jetës së përditshme; - ndjek dhe kupton organizimin logjik të argumenteve; - kupton argumentimin matematik; - përdor dhe trajton mjetet dhe pajisjet teknologjike; - përdor të dhëna shkencore për të arritur një qëllim ose për të marrë një vendim; - regjistron informacionin në forma të ndryshme (tabelore, grafike, përshkruese); - shfrytëzon burime të ndryshme për zhvillimin e ideve dhe të projekteve;	<i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i> - krijon, programon, përdor, përpunon dhe shpërndan përmbajtje digjitale; - interpreton dhe analizon të dhënat për të nxjerrë përfundime dhe për të marrë vendime; - identifikon dhe zgjidh probleme të ndryshme duke përdorur teknologjinë dhe mjediset digjitale; - menaxhon dhe mbron informacionin, përmbajtjen dhe të dhënat personale në hapësirën digjitale; - përdor teknologjinë digjitale për të krijuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët për qëllime personale, sociale dhe mësimore; - përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënës dhe për të rritur efektivitetin në këtë proces; - bashkëpunon me moshatarët e tij duke përdorur teknologjinë, për të

- parashtron pyetje dhe organizon mendimet për zgjidhjen e problemeve; - prezanton idetë për zhvillimin e aktiviteteve dhe i argumenton ato; - shfrytëzon teknika të ndryshme gjatë të nxënës dhe klasifikon informacionin; - propozon dhe planifikon projekte me qëllime, aktivitete dhe burime të ndryshme; - konkretizon rregulla dhe procese me shembuj nga jeta e përditshme.	studiuar tema mësimore, për të zgjidhur çështje dhe probleme që mund të lindin në shkollë dhe jashtë saj; - përdor me saktësi komandat e programeve standarde për përpunimin e teksteve dhe të tabelave për prezantime; - përdor aftësitë e mendimit kritik dhe aftësitë për të zgjidhur probleme në planifikimin e projekteve, duke përdorur mjetet dhe burimet e duhura digjitale.
Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënësit	Kompetenca qytetare
<i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të të nxënësit, nxënësi:</i> - organizon të nxënësit, si dhe vendos dhe realizon qëllimet e tij; - vlerëson në mënyrë kritike punën e tij duke iu referuar qëllimeve fillestare; - motivon dhe vlerëson veten; - mëson dhe punon në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim; - komunikon brenda rregullave dhe bashkëpunon në grup; - kupton dhe vlerëson mënyrën e jetës së shëndetshme; - argumenton nevojën e respektimit të regjimit ushqimor të shëndetshëm;	<i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i> - angazhohet në mënyrë efektive me të tjerët në çështjet të shkollës dhe të komunitetit; - tregon interes në zgjidhjen e problemeve në nivel shkollë dhe komuniteti; - demonstroi tolerancë dhe respekt ndaj dallimeve; - merr pjesë në proceset e vendimmarrjes në klasë dhe në shkollë; - menaxhon dhe zgjidh konfliktet në mënyrë konstruktive dhe të paanshme; - respekton mendimin e tjetrit gjatë diskutimeve në familje, në klasë dhe në shkollë;

- vlerëson domosdoshmërinë e kushteve higjienike për përgatitjen dhe konsumimin e ushqimeve dhe të pijeve; - zhvillon aktivitete fizike dhe sportive me karakter krijues apo garues; - dallon sjelljen korrekte nga ajo jokorrekte gjatë punës në grup ose në situata emocionale dhe propozon masat për parandalimin/tejkalimin e tyre; - reagon ndaj sjelljeve negative duke identifikuar shkaqet dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit (p.sh., nga përdorimi i duhanit apo i alkoolit).	- reagon ndaj personave që shkelin, cenojnë ose mohojnë të drejtat e të tjerëve, duke i ilustruar këto sjellje me shembuj të figurave të shquara historike, personazheve nga letërsia ose filmat; - solidarizohet me personat në nevojë ose të rrezikuar, duke ndërmarrë veprime konkrete për afrimin e ndihmës sipas nevojës që kanë; - reagon me qetësi ndaj sjelljeve/veprimeve jokorrekte që ndodhin në klasë ose në shkollë; - identifikon dukuritë jo të mira në klasë apo në shkollë dhe mban qëndrim ndaj tyre duke propozuar veprime konkrete parandalimi; - prezanton të kaluarën e familjes, të rrethit shoqëror ose të personaliteteve dhe të ngjarjeve kryesore të kombit të vet, duke krahasuar të tashmen me të kaluarën.
Kompetenca e sipërmarrjes	Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
<i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i> - mendon në mënyrë kritike dhe zgjidh problemin; - përdor imagjinatën e tij gjatë proceseve krijuese dhe novatore; - komunikon në mënyrë efektive dhe negocion me të tjerët; - përballlet me pasigurinë, paqartësinë dhe rrezikun për vendimet që ndërmerr; - punon në mënyrë të pavarur, si dhe bashkëpunon me të tjerët; - vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup, për	<i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i> - njeh dhe respekton kulturën e tij si dhe vlerat dhe kulturat e të tjerëve; - shpreh dhe interpreton idetë, përvojat dhe emocionet në arte të ndryshme; - shijon dhe vlerëson veprat e artit; - shpreh veten në media të ndryshme, duke përdorur dhe duke përmirësuar kapacitetin personal;

zhvillimin e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme; - ndërmerr aktivitete të ndryshme për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore për shkollën; - analizon pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut, duke i paraqitur idetë në formë të shkruar ose në ndonjë formë tjetër të shprehurit; - zhvillon një plan për shpenzimet dhe kursimet mujore personale dhe argumenton rëndësinë e planifikimit të buxhetit; - përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim; - propozon kriteret për vlerësim të një aktiviteti sportiv, shkencor, teknologjik, artistik etj., (si anëtar jurie të ngritur në nivel klase); - hulumton nevojat e shkollës dhe në bazë të të dhënave organizon veprimtari për plotësimin ose përmirësimin e nevojave.	- identifikon dhe realizon mundësitë për të shprehur vlera personale dhe sociale nëpërmjet arteve dhe formave të tjera kulturore; - angazhohet në proceset krijuese individualisht dhe në grup.
---	--

4.2. Integrimi i temave ndërkurrikulare në lëndën e gjuhës shqipe

Temat ndërkurrikulare janë aspekte të rëndësishme që reflektojnë çështje madhore me të cilat përballet shoqëria sot dhe në të ardhmen. Ato integrohen në të gjitha lëndët e kurrikulës dhe ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë lidhjet mes njohurive nga fusha dhe lëndë të ndryshme, të krijojnë një vizion më të gjerë për botën dhe të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre në një mjedis global dhe ndërveprues.

Temat ndërkurrikulare të cilat janë përcaktuar në kurrikulën bërthamë të arsimit të mesëm të ulët, janë:

- Identiteti kombëtar.
- Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.
- Shëndeti mendor e fizik dhe siguria.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Teknologjia, shoqëria dhe media.

Lënda e gjuhës shqipe ofron mundësi të shumta për integrimin e temave ndërkurrikulare në procesin mësimor. Përmes kësaj lënde, nxënësit mund të ndërtojnë dhe të forcojnë *identitetin kombëtar* duke studiuar tekstet letrare që pasqyrojnë historinë dhe traditat shqiptare; të zhvillojnë *qytetarinë aktive dhe sipërmarrjen* përmes projekteve dhe debateve mbi çështjet sociale; të ndërgjegjësohen për *shëndetin mendor dhe fizik* duke analizuar tekste që trajtojnë mirëqenien personale dhe sigurinë; të reflektojnë mbi *zhvillimin e qëndrueshëm dhe qëndrueshmërinë mjedisore* përmes eseve dhe diskutimeve për mbrojtjen e mjedisit; si dhe të kuptojnë ndikimin e *teknologjisë, shoqërisë dhe medias* përmes analizës së gjuhës së përdorur në komunikimin digjital dhe në media.

Më poshtë paraqiten disa shembuj të trajtimit të secilës temë ndërkurrikulare në lëndën e gjuhës shqipe.

- ***Identiteti kombëtar:*** Gjuha shqipe është shtyllë kryesore e identitetit kombëtar dhe e kulturës shqiptare. Përmes leximit të teksteve letrare, si ato të Naim Frashërit, Gjergj Fishtës apo Ismail Kadaresë, nxënësit mund të mësojnë për trashëgiminë kulturore, figurat historike dhe ngjarjet që kanë formësuar identitetin tonë. Poezitë patriotike, këngët epike dhe tekstet historike ndihmojnë në forcimin e ndjenjës së përkatësisë dhe të krenarisë kombëtare.
- ***Qytetaria aktive dhe sipërmarrja:*** Lënda e gjuhës shqipe ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë për të marrë pjesë aktive në shoqëri dhe për të zhvilluar aftësitë sipërmarrëse. Për shembull, përmes projekteve ku nxënësit krijojnë revistën e shkollës, shkruajnë artikuj për problemet lokale ose diskutojnë për çështje shoqërore, ata mësojnë të jenë qytetarë të angazhuar dhe të përgjegjshëm. Po ashtu, trajtimi i teksteve që frymëzojnë për iniciativë dhe shpirt krijues, si tregimet për figura të suksesshme shqiptare, ndihmon në zhvillimin e aftësive sipërmarrëse.


- ***Shëndeti mendor e fizik dhe siguria:*** Përmes përzgjedhjes së teksteve që trajtojnë tema të shëndetit mendor dhe fizik, si tregimet për përballimin e sfidave personale, poezitë motivuese apo tekstet informuese për shëndetin, nxënësit mund të ndërtojnë një qasje pozitive ndaj mirëqenies së tyre. Diskutimet për rëndësinë e stilit të shëndetshëm të jetesës, mbrojtjen nga rreziqet online dhe kujdesin për shëndetin mendor ndihmojnë në zhvillimin e aftësive për të përballuar stresin dhe për të ndërtuar vetëbesimin.
- ***Zhvillimi i qëndrueshëm:*** Në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit mund të përfshihen në projekte dhe ese që trajtojnë çështje mjedisore, si: mbrojtja e burimeve natyrore, shkaqet dhe pasojat e ndotjes etj. Për shembull, analiza e poezive që përshkruajnë bukuritë natyrore të Shqipërisë ose shkrimi i esëve për ndryshimet klimatike dhe pasojat e tyre për komunitetin, ndihmojnë nxënësit të kuptojnë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përgjegjësinë ndaj mjedisit.
- ***Teknologjia, shoqëria dhe media:*** Lënda e gjuhës shqipe mund të përdoret për të analizuar ndikimin e teknologjisë dhe të medias në shoqëri. Përmes analizës së gjuhës së përdorur në rrjetet sociale, diskutimeve për etikën e komunikimit online dhe vlerësimeve të teksteve mediatike, nxënësit zhvillojnë aftësi për të kuptuar, për të analizuar dhe për të vlerësuar ndikimin e medias në jetën e tyre dhe për të bërë zgjedhje të përgjegjshme në hapësirën digjitale.

Shënim. Veprimtari praktike të zhvillimit të temave ndërkurrikulare do të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë.

4.3. Kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe

Për të përmbushur qëllimet e saj, lënda e gjuhës shqipe zhvillon katër kompetenca, të cilat lidhen me kompetencat kyç që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij.

Korniza konceptuale e lëndës së gjuhës shqipe



Kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe

Në tabelën e mëposhtme është dhënë një përshkrim i çdo kompetence lëndore dhe rezultatet e të nxënit

Kompetenca lëndore	Përshkrimi i kompetencës	Rezultatet e të nxënit
Të dëgjuarit dhe të folurit për qëllime të ndryshme	Kjo kompetencë është e rëndësishme, sepse përmes të folurit dhe të dëgjuarit nxënësit jo vetëm që transmetojnë informacion, por edhe zbulojnë dhe kuptojnë ide dhe koncepte, identifikojnë dhe zgjidhin probleme, organizojnë përvojat dhe njohuritë e tyre, si dhe shprehin dhe qartësojnë mendimet, ndjenjat dhe qëndrimet e tyre. Njohuritë dhe aftësitë për të dëgjuar dhe për të folur janë të domosdoshme për ndërveprim shoqëror në familje, në shkollë dhe kudo. Për të zhvilluar këtë kompetencë, nxënësit kanë nevojë për më shumë mundësi për të dëgjuar dhe për të folur për një gamë të gjerë temash, duke përfshirë interesat vetjakë, detyrat shkollore dhe ngjarjet aktuale. Lënda e gjuhës shqipe duhet të ofrojë mundësi për nxënësit që të angazhohen në aktivitete të ndryshme të të folurit, si për shembull: të japin përshtypjet e tyre për një tekst të ri që lexojnë, të diskutojnë strategjitë për zgjidhjen e një problemi në një punë me shkrim, të paraqesin dhe të mbrojnë mendime apo të debatojnë për çështje të ndryshme, të analizojnë punën e bashkëmoshatarëve etj. Gjatë zbatimit të programit, mësuesi duhet të përqendrohet në identifikimin dhe zhvillimin e aftësive dhe të strategjive që përdorin	Nxënësi: - dëgjon për të kuptuar dhe për t'u përgjigjur në mënyrë të përshtatshme në situata të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme; - përdor aftësi dhe strategji të të folurit në mënyrë të përshtatshme për të komunikuar me dëgjues të ndryshëm dhe për qëllime të ndryshme; - reflekton dhe identifikon pikat e tij të forta si dëgjues dhe folës, fushat ku ka nevojë për përmirësim, si dhe strategjitë që e kanë ndihmuar më shumë në situata të ndryshme komunikimi; - përdor gjuhën standarde gjatë të folurit.

	dëgjuesit dhe folësit efektivë për të kuptuar dhe për të ndërvepruar me të tjerët.	
Të lexuarit e teksteve të ndryshme	Për të ndërtuar dhe për të zhvilluar këtë kompetencë, nxënësit integrojnë komponentët e kuptimit në nivel fjale, fjalie dhe teksti ndërsa përdorin strategjitë e të kuptuarit dhe zbatojnë aftësi të menduarit kritik për t'u thelluar në kuptimin dhe reflektimin ndaj teksteve gjithnjë e më komplekse. Gjatë leximit të teksteve, nxënësit zbatojnë njohuritë dhe aftësitë bazë dhe mbështeten në fjalorin dhe njohuritë e tyre të mëparshme. Ata mësojnë mbi modelet, veçoritë dhe elementet e stilit të lidhura me forma dhe gjini të ndryshme tekstesh, përfshirë tekste digjitale dhe mediatike. Nxënësit lexojnë tekste të krijuara nga shkrimtarë dhe autorë të periudhave dhe të kulturave të ndryshme (shqiptare dhe botërore). Nxënësit analizojnë tekste të ndryshme letrare dhe joletrare për të kuptuar mënyrën se si autorët përdorin gjuhën dhe figurat stilistike për të shprehur kuptimin. Ata nxjerrin përfundime duke përdorur dëshmi të shprehura ose të nënkuptuara në tekst. Nxënësit identifikojnë idetë kryesore dhe rendisin informacionin përkatës, krahasojnë dhe kundërshtojnë, nxjerrin përfundime, vendosin lidhje mes ideve të shprehura në tekste të ndryshme dhe sintetizojnë	Nxënësi: - zbaton strategjitë e të kuptuarit para, gjatë dhe pas leximit të teksteve të ndryshme, me qëllim që t'i kuptojë ato; - përdor njohuritë dhe aftësitë bazë për të kuptuar tekste të ndryshme, përfshirë tekste digjitale dhe mediatike, nga shkrimtarë dhe autorë të periudhave dhe të kulturave të ndryshme (shqiptare dhe botërore), si dhe analizon dhe vlerëson elemente të përmbajtjes, veçori dhe elemente të stilit që lidhen me forma dhe gjini të ndryshme teksti; - zbaton aftësitë e të menduarit kritik për t'u thelluar në kuptimin e teksteve dhe për të analizuar se si trajtohen këndvështrime dhe subjekte të ndryshme në tekste të ndryshme, përfshirë tekstet digjitale dhe mediatike.

	informacionin e përftuar prej tyre. Ata zbatojnë aftësi të të menduarit kritik për të identifikuar këndvështrimet e shprehura dhe të nënkuptuara dhe shqyrtojnë mënyrën se si elementet kulturore dhe identitetet e autorëve pasqyrohen në tekstet e tyre.	
Krijimi i teksteve të ndryshme	Për të ndërtuar dhe për të zhvilluar këtë kompetencë, nxënësit mësojnë të krijojnë tekste në forma dhe gjini të ndryshme, duke përdorur media të ndryshme. Gjatë procesit të krijimit të teksteve, ata zhvillojnë aftësitë për të planifikuar, hulumtuar e hartuar draftet, për të rishikuar, redaktuar, korrektuar, publikuar dhe për të ndarë tekstet e tyre. Nxënësit shkruajnë me shkrim dore dhe në kompjuter, marrin parasysh qëllimin dhe lexuesin e tyre kur zgjedhin format, gjinitë dhe mediat e përshtatshme për të krijuar tekste mbi tema të ndryshme, përfshirë ato që lidhen me përvojat e tyre personale. Nxënësit përdorin gjuhë të pasur dhe të përshtatshme për të dhënë këndvështrimin dhe perspektivat e tyre, si dhe për të përcjellë mesazhin e synuar. Ata zbatojnë njohuritë e tyre rreth sistemit gjuhësor të shqipes në të shkruar dhe përdorin modele tekstesh, veçori dhe elemente stilistike për të shprehur idetë e tyre në mënyrë të qartë dhe koherente me qëllim që të arrijnë efektet e dëshiruara.	Nxënësi: - planifikon, zhvillon ide, mbledh dhe organizon informacion për shkrimin e teksteve të ndryshme, duke përfshirë tekste digjitale dhe mediatike, me tematika të përshtatshme për moshën e tij; - zbaton njohuritë rreth formave dhe gjinive të ndryshme të tekstit për të krijuar, rishikuar, redaktuar dhe korrigjuar tekstet e tij, si dhe reflekton në mënyrë kritike për tekstet e krijuara; - zgjedh media, teknika dhe mjete të përshtatshme dhe efektive për të prezantuar tekstet dhe analizon në mënyrë kritike trajtimin e temave të ndryshme në tekste.

	Gjatë të gjitha klasave, nxënësit mësojnë të kërkojnë dhe të mbledhin informacion. Ata zhvillojnë aftësinë për të verifikuar besueshmërinë e burimeve dhe për të vlerësuar nëse janë aktuale, si dhe cilësinë, paanshmërinë dhe saktësinë e informacioneve. Gjithashtu, nxënësit mësojnë si të njohin dhe të citojnë si duhet veprat e të tjerëve duke respektuar të drejtën e autorit.	
Përdorimi i drejtë i gjuhës	Kjo kompetencë është e rëndësishme, sepse, nxënësit që të flasin dhe të shkruajnë në mënyrën e duhur, duhet të zotërojnë njohuri e të demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës shqipe. Për ndërtimin dhe zhvillimin e kësaj kompetence, mësuesi krijon mundësi që nxënësit të dallojnë pjesët e ndryshme të ligjëratës e kategoritë gramatikore të tyre dhe t'i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit; të dallojnë llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe t'i zbatojnë këto njohuri në komunikimin e përditshëm; të përdorin gjuhën standarde, të njohin dialektet e pjesë të tjera të leksikut dhe të respektojnë diversitetin gjuhësor; të përvetësojnë njohuri për mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe; të dallojnë kuptimet e fjalëve dhe t'i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre.	Nxënësi: - demonstroi njohuri dhe shkathtësi për gjymtyrët kryesore dhe të dyta, për llojet e fjalive sipas kumtimit, për fjalitë që shprehin pohim ose mohim, për përdorimin e ligjëratës së drejtë dhe të ligjëratës së zhdrejtë, për klasat e fjalëve të ndryshueshme (kategoritë e tyre gramatikore) dhe fjalët e pandryshueshme, për përbërësit e fjalës dhe mënyrat e formimit të saj; - zbaton dhe argumenton rregullat drejtshkrimore, si dhe përdor drejt shenjat e pikësimit.

V. PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT


5.1. Koha mësimore për secilën kompetencë për klasën e gjashtë

Lënda e gjuhës shqipe zhvillohet me 5 orë mësimore në javë ose gjithsej 175 orë gjatë një viti shkollor, i cili zgjat 35 javë. Në këtë rubrikë është sugjeruar numri i orëve për çdo kompetencë të lëndës së gjuhës shqipe. Në këtë ndarje duhet pasur parasysh që nxënësi i zhvillon kompetencat gjuhësore çdo orë mësimi, por në orë të veçanta theksi vihet më së shumti në njërën prej tyre (në të shkruarit, në të lexuarit etj.), dhe kjo gjë përcakton numrin e orëve për këtë kompetencë. Kjo ndarje e orëve është sugjeruese dhe synon të ***orientojë mësuesit për rëndësinë e secilës kompetencë në raport me kohën totale kushtuar mësimit të gjuhës shqipe gjatë një viti shkollor***. Për lehtësi në planifikim, mësuesve u sugjerohen rreth 25 orë që mund të përdoren për projekt, përsëritje, teste, biseda letrare ose lexime jashtë klase etj. Ndërsa ndarja e orëve sipas kompetencave është sugjeruese dhe fleksibël, ***totali prej 175 orësh është i pandryshueshëm***.

Klasa	Të dëgjuarit dhe të folurit për qëllime të ndryshme	Të lexuarit e teksteve të ndryshme	Krijimi i teksteve të ndryshme	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Të tjera	Gjithsej
VI	15	60	15	60	25	175

5.2. Përmbajtja mësimore e klasës së gjashtë

Në programin e gjuhës shqipe janë paraqitur rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë. Rezultatet e të nxënit janë pritshmëri të përgjithshme, të cilat shprehen në terma njohurish, aftësish, vlerash dhe qëndrimesh specifike për çdo klasë. Rëndësia e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në program nuk nënkupton që përmbajtja mësimore përgjatë vitit shkollor të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi, ndarja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në kapituj apo grupe temash e njësi mësimore është e drejtë e përdoruesve kryesorë të programit, pra e mësuesve dhe e autorëve të teksteve shkollore.



Të dëgjuarit dhe të folurit për qëllime të ndryshme	
Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë	
Nxënësi:	
- dëgjon për të kuptuar dhe për t'u përgjigjur në mënyrë të përshtatshme në situata të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme; - përdor aftësi dhe strategji të të folurit në mënyrë të përshtatshme për të komunikuar me dëgjues të ndryshëm dhe për qëllime të ndryshme; - reflekton dhe identifikon pikat e tij të forta si dëgjues dhe folës, fushat ku ka nevojë për përmirësim, si dhe strategjitë që e kanë ndihmuar më shumë në situata të ndryshme komunikimi; - përdor gjuhën standarde gjatë të folurit.	
Njohuri	Aftësi
<i>Njohuritë për të dëgjuarit</i>	<i>Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të vlerësuar</i>
- Qëllimet e dëgjimit: Pse dëgjojmë? (për të kuptuar, për të mësuar, për t'u përfshirë etj.).	Nxënësi:

- Strategjitë bazë të të dëgjuarit. - Fakti dhe opinionimi. - Roli i zërit dhe i gjuhës së trupit (<i>si ndihmojnë toni i zërit, mimika, gjestet për të kuptuar më mirë</i>). - Vlerësimi i një teksti (<i>A është i qartë? A përdor shembuj? Si ndikon te dëgjuesi?</i>). Njohuritë e mësipërme integrohen me njohuritë dhe aftësitë e të dëgjuarit të teksteve, si p.sh.: - materiale audio (audiobooks) me përralla, tregime popullore ose fragmente nga romane të thjeshta për fëmijë; - <i>podcast</i>-e për fëmijë rreth çështjeve që lidhen me letërsinë, gjuhën ose temat ndërkurrikulare; - intervista me autorë librash për fëmijë, artistë, shkencëtarë ose sportistë që flasin thjesht dhe qartë; - dokumentarë të shkurtër për moshën e nxënësve, me një zë (rrëfyes) që i shpjegon; - video shpjeguese ose udhëzuese (p.sh., si të shkruash një tregim të shkurtër); - reklama digjitale ose fushata ndërgjegjësimi për fëmijë (p.sh., për kujdesin për mjedisin, sigurinë në internet, shëndetin).	- identifikon qëllimin e të dëgjuarit në situata të ndryshme, si formale ashtu edhe joformale, (<i>p.sh.: për të kuptuar përmbajtjen e një prezantimi; për të identifikuar strategjitë dhe mjetet e thjeshta që përdoren për të shtuar ndikimin e një fjalimi; për të përshkruar idetë e shprehura dhe të nënkuptuara në tekstin e një poezie</i>); - përdor rregullat e dëgjimit aktiv duke bërë pyetje, si dhe duke përdorur shprehje që tregojnë interes, ndjeshmëri dhe vlerësim gjatë bisedës; - përdor strategji të ndryshme për të kuptuar një tekst të dëgjuar, si: të pyesë veten gjatë dëgjimit, të krijojë përfytyrim pamor të asaj që thuhet në mendje ose të mbajë shënime për idetë dhe çështjet kryesore; - përmbledh dhe shpjegon informacionin e dëgjuar duke cituar detaje të rëndësishme; - interpreton mesazhet dhe idetë e nënkuptuara në tekst duke u kushtuar vëmendje tonit të zërit, gjuhës së trupit dhe mimikës së folësit; - krahason dhe lidh idetë e dëgjuara me përvojat dhe njohuritë personale, me tekste të tjera ose me ngjarje nga jeta reale; - analizon dhe vlerëson mënyrën si komunikohet përmbajtja në një tekst të dëgjuar duke shpjeguar pse ka ndikim te dëgjuesi; - identifikon këndvështrimet e paraqitura në tekst, vlerëson nëse pajtohet me to dhe sugjeron këndvështrime të tjera të mundshme;
--	---

<i>Njohuritë për të folurit</i> - Qëllimet e të folurit (<i>për të shprehur mendime, për të treguar, për të përshkruar, për të bindur, për të ndarë ndjenja etj.</i>). - Hartimi i një prezantimi të thjeshtë: <i>hyrje</i>: çfarë do të thuash; <i>zhvillim</i>: idetë kryesore me shembuj; <i>mbyllje</i>: përfundimi ose përfundimet. - Zgjedhja e fjalëve dhe përdorimi i gjuhës së qartë ose të kuptueshme. - Elementet e komunikimit joverbal. - Përdorimi i elementeve pamore të thjeshta (<i>postera, vizatime, imazhe, skema të thjeshta</i>). - Llojet kryesore të teksteve: ✓ rrëfime personale; ✓ tregime imagjinare; ✓ përshkrime (p.sh., i një personi, vendi ose ngjarjeje); ✓ prezantime për një temë të caktuar; ✓ shpjegime ose udhëzime praktike (p.sh.: si bëhet diçka, si funksionon diçka); ✓ njoftime të thjeshta;	- zbulon strategjitë që përdor folësi (<i>humori, pauzat, ndryshimi i ritmit</i>) dhe analizon efektin e tyre te dëgjuesi; - dallon faktet nga opinionet në tekstet e dëgjuara dhe shpjegon pse ato janë të rëndësishme për të kuptuar dhe gjykuar më mirë tekstin; - vlerëson besueshmërinë e informacionit duke pyetur kush e thotë, cilat janë provat, faktet dhe cili është qëllimi i mesazhit; - sugjeron përmirësime për mënyrën e paraqitjes së një mesazhi që dëgjon, duke reflektuar për përmbajtjen dhe ndikimin e tij; - reflekton për mënyrën se si dëgjon dhe për strategjitë që e ndihmojnë të kuptojë më mirë tekstet që dëgjon. <i>Të folurit për të komunikuar</i> Nxënësi: - identifikon qëllimin e të folurit dhe shpjegon si ndryshon mënyra e të folurit sipas dëgjuesit dhe situatës (p.sh.: <i>kur komunikon me shokët, flet lirshëm; kur flet para klasës, është më i kujdesshëm; kur luan role, përshtat fjalët dhe tonin sipas personazhit</i>); - dallon shpejtësinë e të folurit dhe di kur duhet të flasë më ngadalë (p.sh., kur shpjegon diçka të re) ose më shpejt (p.sh., kur tregon diçka emocionuese);
--	--

✓ argumente të thjeshta për të mbështetur një mendim ose një qëndrim.	- komunikon qartë, duke lidhur idetë në mënyrë logjike dhe duke përdorur shembuj ose argumente për të mbështetur ato që thotë (p.sh., shpjegon pse mendon që një ide është e mirë ose e dobishme); - përdor fjalë dhe shprehje që e bëjnë më të gjallë rrëfimin (p.sh.: krahasime, përshkrime, pyetje retorike); - përdor elemente, si toni, ritmi, intonacioni dhe volumni, për të shprehur idetë dhe ndjenjat e tij; - përdor gjuhën e trupit (mimikën, gjestet, kontaktin me sy) për të përforcuar mesazhin e tij, duke treguar siguri, interes dhe duke ndihmuar dëgjuesin të ndjekë idetë (p.sh.: kur numëron çështjet, përdor gishtat; kur është i habitur, e shpreh edhe me mimikë); - përdor mjete pamore (p.sh., <i>postera, tabela, vizatime, objekte</i>) për të mbështetur ose për të pasuruar prezantimet; - praktikohet para se të flasë, për të qenë më i sigurt dhe më i qartë për dëgjuesit; - tregon një ngjarje personale, duke renditur episodet me radhë dhe duke përshkruar ndjesitë ose mendimet e veta; - rrëfen një tregim imagjinar ose një përrallë të thjeshtë, duke krijuar personazhe dhe duke ndërtuar një rrëfim me fillim, mes dhe fund; - përshkruan një person, vend ose ngjarje, duke përdorur fjalë që japin detaje dhe e ndihmojnë dëgjuesin të krijojë një përfytyrim të qartë në mendje;
--	--

	- bën një prezantim të shkurtër për një temë të caktuar, duke dhënë informacion të qartë dhe të organizuar për dëgjuesit; - shpjegon ose udhëzon se si përdoret diçka, duke ndjekur hapat me radhë dhe duke përdorur shembuj të thjeshtë; - jep një njoftim të thjeshtë, duke përfshirë informacionin e nevojshëm që dëgjuesi të kuptojë mirë çfarë, kur dhe ku ndodh diçka; - shpreh argumente të thjeshta për të mbështetur një mendim ose një qëndrim, duke dhënë arsye dhe shembuj të qartë; - përdor struktura të sakta gjuhësore dhe fjalor të përshtatshëm për të komunikuar me qartësi dhe saktësi; - gjykon mënyrën si flet, identifikon pikat e forta dhe të dobëta në të folurit e tij, propozon strategji për ta përmirësuar komunikimin.
Vlera dhe qëndrime Nxënësi: - respekton bashkëbiseduesin, duke e dëgjuar me vëmendje dhe pa e ndërprerë kur është duke folur; - shpreh qartë mendimet dhe ndjenjat e tij, duke përdorur fjalor të përshtatshëm për situatën dhe për dëgjuesit; - tregon mirëkuptim dhe empati, duke marrë parasysh pikëpamjet dhe ndjenjat e të tjerëve gjatë bisedës; - është i hapur ndaj komenteve dhe sugjerimeve, duke i pranuar ato me qëllim përmirësimi; - demonstroi durim dhe vetëpërmbytje, sidomos në situata ku ka kundërshtime ose debate; - përfshihet në mënyrë aktive në diskutime; - përdor gjuhë të përshtatshme për të mbrojtur një mendim, pa cenuar dinjitetin e bashkëbiseduesit;	

- reflekton për mënyrën si komunikon, për të përmirësuar vazhdimisht aftësitë për të folur dhe për të dëgjuar në mënyrë efektive.

Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- zbaton strategjitë e të kuptuarit para, gjatë dhe pas leximit të teksteve të ndryshme, me qëllim që t'i kuptojë ato;
- përdor njohuritë dhe aftësitë bazë për të kuptuar tekste të ndryshme, përfshirë tekste digjitale dhe mediatike, nga shkrimtarë dhe autorë të periudhave dhe të kulturave të ndryshme (shqiptare dhe botërore), si dhe analizon dhe vlerëson elemente të përmbajtjes, veçori dhe elemente të stilit që lidhen me forma dhe gjini të ndryshme teksti;
- zbaton aftësitë e të menduarit kritik për t'u thelluar në kuptimin e teksteve dhe për të analizuar se si trajtohen këndvështrime dhe subjekte të ndryshme në tekste të ndryshme, përfshirë tekstet digjitale dhe mediatike.

Njohuri	Aftësi
- Strategjitë për të kuptuar tekstet. - Teknikat e recitimit. - Tema dhe mesazhi në tekst. - Subjekti/përmbajtja, rrëfyesi, personazhi, koha, vendi, ngjarjet, veta e rrëfimit. - Figurat letrare: krahasimi, metafora, personifikimi dhe hiperbola dhe funksioni i tyre. Rima dhe aliteracioni.	<i>Strategjitë për të kuptuar (zhvillohen në të gjitha tekstet)</i> Nxënësi: <i>Para leximit: Aktivizimi i njohurive të mëparshme dhe përcaktimi i qëllimit të leximit</i> - identifikon dhe shpjegon njohuritë e mëparshme, përfshirë përvojat personale dhe të nxënit në lëndë të tjera mësimore që mund të ndihmojnë në kuptimin e teksteve të reja;

- Llojet e teksteve: tekste letrare dhe tekste joletrare. Dallimet kryesore mes tyre. - Tekste letrare të letërsisë shqipe dhe botërore: ✓ tregime ose fragmente tregimesh; ✓ përralla ose legjenda; ✓ poezi të thjeshta; ✓ fragmente nga romane ose romane për fëmijë; ✓ fabula; ✓ pjesë dramatike ose skena nga drama për fëmijë. - Tekste joletrare përfshirë edhe tekste digjitale: ✓ artikuj të thjeshtë informues, njoftime, përshkrime, tekste shpjeguese, udhëzime; ✓ artikuj të thjeshtë online për fëmijë (nga faqe edukative ose revista online); ✓ përmbajtje nga enciklopedi digjitale; ✓ përmbledhje lajmesh për fëmijë (në formë teksti ose të shoqëruara me video) - Elemente të teksteve joletrare: tituj, nëntituj, tabela, lista, fakti dhe opinioni, modele si problem-zgjidhje ose rend kronologjik e logjik.	- zgjedh tekste nga autorë të ndryshëm që përputhen me qëllimet e tij dhe shpjegon pse zgjedhjet janë të përshtatshme. <i>Gjatë leximit: Parashikimi dhe konfirmimi i të kuptuarit; kontrolli i vazhdueshëm i kuptimit</i> - bën parashikime duke përdorur njohuritë e mëparshme dhe informacionin nga teksti, si dhe pyet për të kontrolluar saktësinë e parashikimeve; - përdor strategji, si vizualizimi, hartimi i pyetjeve dhe konsultimi me burime të tjera, për të konfirmuar kuptimin e teksteve të ndryshme. <i>Gjatë dhe pas leximit: Lidhja me përvoja dhe njohuri</i> - shpjegon se si idetë e shprehura në tekst lidhen me njohuritë dhe me përvojat personale, me idetë në tekste të tjera dhe me botën që e rrethon. <i>Pas leximit: Përmbledhja dhe nxjerrja e përfundimeve</i> - përmbledh dhe përcakton idenë kryesore dhe detajet mbështetëse në tekste të ndryshme dhe nxjerr përfundime të mbështetura mirë në tekst; - shpjegon se si strategji të ndryshme, si vizualizimi, parashikimi, përmbledhja dhe lidhja me përvojën, e kanë ndihmuar për të kuptuar tekstet dhe vendos objektiva për përmirësimin e mëtejshëm. <i>Të lexuarit e teksteve letrare</i> Nxënësi: - rrëfen me fjalët e veta ngjarjet kryesore të tekstit letrar, duke ndjekur rendin: hyrja- zhvillimi- mbyllja;
---	---

Sugjerime për përdoruesit e programit - <i>Raporti tekste letrare (42 orë) – tekste joletrare (18 orë)</i> Sugjerohet që nxënësit të lexojnë tekste letrare (afërsisht 70% e teksteve të zgjedhura), dhe tekste joletrare (afërsisht 30%). - <i>Raporti letërsi shqipe (rreth 26 orë) – letërsi botërore (rreth 16 orë)</i> Sugjerohet që përzgjedhja e teksteve letrare të jetë e balancuar mes shkrimtarëve shqiptarë dhe atyre të letërsisë botërore. Tekstet nga letërsia shqipe ndihmojnë në zhvillimin e identitetit kombëtar, ndërsa tekstet nga letërsia botërore kontribuojnë në zgjerimin e horizontit kulturor. <i>Raporti prozë - poezi - dramë</i> Në klasën e gjashtë, fokusi sugjerohet kryesisht te proza (afërsisht 50–60% e teksteve letrare), poezia mund të zërë rreth 30–40% të leximeve, ndërsa drama sugjerohet në mënyrë më të kufizuar (rreth 10–20%).	- dallon pjesët kryesore të subjektit (përmbajtjes): hyrjen, zhvillimin, kulmin dhe përfundimin; - tregon se si veprimet e personazheve e ndryshojnë ecurinë e ngjarjeve në tekst; - krahason mënyrën si zhvillohen subjektet në lloje të ndryshme tekstesh, p.sh., në një tregim dhe në një përrallë; - përdor tabela ose harta mendore për të treguar rendin e ngjarjeve dhe lidhjen mes tyre; - parashikon se si mund të vazhdojnë ngjarjet në një tekst, duke u mbështetur në detajet e tekstit dhe në ilustrimet (foto, figura) që e shoqërojnë tekstin; - harton një mbyllje tjetër për një tekst, duke propozuar një përfundim alternativ; - përshkruan ndjesitë, emocionet (përjetimet personale) që i ngjall zhvillimi i subjektit ose veprimet e personazheve; - përdor mjete digjitale (p.sh., platforma leximi, libra elektronikë) për të lexuar dhe ndjekur zhvillimin e subjektit; - dallon kush tregon ngjarjen (personazh, zë i jashtëm); - dallon rrëfimin në vetën e parë nga rrëfimi në vetën e tretë; - dallon personazhet kryesorë dhe jo kryesorë në një tekst; - përshkruan tipare të jashtme ose sjellje të personazheve, duke dhënë shembuj nga teksti; - shpjegon rolin e protagonistit (kryesorit) dhe antagonistit (nëse ka);
--	---

- analizon marrëdhënie të thjeshta mes personazheve (p.sh., miqësi, kundërshti, bashkëpunim);
- tregon me shembuj se si ndryshon një personazh nga fillimi deri në fund të tekstit;
- rrëfen me fjalët e veta pjesë të tekstit duke u përqendruar tek veprimet e personazheve;
- dallon konfliktin kryesor në një tekst;
- argumenton nëse konflikti është mes personazheve, mes personazhit dhe natyrës/shoqërisë, apo brenda vetes së personazhit;
- përshkruan me shembuj se si konflikti ndikon në zhvillimin e ngjarjes;
- përshkruan kohën dhe vendin ku zhvillohet veprimi i një proze, poezie ose drame;
- tregon se si koha dhe vendi ndikojnë te personazhet ose te zhvillimi i ngjarjeve;
- përshkruan kuptimin e fjalëve dhe të shprehjeve në kontekstin e tekstit, përfshirë edhe kuptimin e figurshëm;
- dallon dhe emërton figura stilistike (letrare) të thjeshta (metafora, krahasimi, personifikimi, hiperbola);
- shpjegon me shembuj të thjeshtë se si figurat stilistike (letrare) e bëjnë tekstin më të gjallë e tërheqës;
- dallon elemente si rima dhe aliteracioni dhe tregon rolin e tyre në krijimin e ritmit e të muzikalitetit të vargut;

- dallon temën kryesore të një tregimi, poezie ose drame;
- përshkruan me fjalët e veta se si shfaqen në tekst tema të zakonshme (p.sh. dashuria, humbja, miqësia, liria) dhe çfarë kupton prej tyre.
- tregon me shembuj nga teksti se si përcillet tema përmes ngjarjeve, personazheve ose konfliktit;
- krahason mënyrën se si trajtohet e njëjta temë në dy tekste të ndryshme;
- dallon tiparet kryesore të një proze, poezie ose drame (specifikisht të teksteve që janë përcaktuar të njohuritë):
- lidh disa elemente të tekstit me të dhëna të thjeshta për jetën e autorit;
- krahason përvojën e leximit të një tregimi, drame apo poezie me përvojën e dëgjimit ose të shikimit të të njëjtit tekst;
- reciton poezi ose fragmente të shkurtra nga tekste letrare me intonacion dhe me ndjeshmëri të përshtatshme;
- lexon dhe kupton në mënyrë të pavarur tekste letrare nga letërsia shqipe dhe botërore, nga gjini, periudha dhe këndvështrime të ndryshme, me kompleksitet të përshtatshëm për klasën e 6-të.

Të lexuarit e teksteve joletrare

Nxënësi:

- përcakton qëllimin e autorit në një tekst dhe shpjegon se si përcillet ky qëllim nëpërmjet përmbajtjes;

	- përcakton idenë ose idetë qendrore të tekstit dhe shpjegon se si hollësi të veçanta ndihmojnë në përcjelljen e tyre; - harton një përmbledhje të tekstit; - dallon faktet dhe opinionet në tekst; - citon dëshmi, shembuj nga teksti për të mbështetur analizën e tekstit, si dhe përfundimet që nxirren prej tij; - analizon në hollësi se si një individ, ngjarje apo ide kyç prezantohet, ilustrohet dhe zhvillohet në tekst (p.sh., përmes shembujve ose rrëfimeve të shkurtra); - shpreh pyetje, mendime ose reagime personale mbi idetë që përcjell teksti joletrar; - përcakton kuptimin e fjalëve dhe të shprehjeve siç përdoren në tekst, përfshirë kuptimet e figurshme, si dhe shpjegon se si përzgjedhja e fjalëve ndikon në kuptim; - shpjegon si është organizuar një tekst joletrar (hyrje, zhvillim i ideve, përfundim); - analizon se si një fjali, paragraf, kapitull, pjesë apo veçori e tekstit (p.sh., një titull) përshtatet në strukturën e përgjithshme të tekstit dhe ndihmon në zhvillimin e ideve; - përdor harta mendore ose tabela për të organizuar idetë dhe faktet kryesore të një teksti joletrar; - ndërthur informacionin e paraqitur në formate të ndryshme (p.sh., tabela, grafikë, fotografi, video, harta) me tekstin e shkruar, për të ndërtuar një kuptim të qartë të të gjithë tekstit;
--	---

	- përdor mjete digjitale për të eksploruar, krahasuar dhe kuptuar tekste joletrare (p.sh. artikuj online, platforma mësimore etj.). - zbulon dhe vlerëson argumentet dhe pohimet specifike të një teksti, duke dalluar ato që mbështeten me fakte nga ato që nuk mbështeten; - krahason mënyrën se si një autor paraqet ngjarjet, me një autor tjetër (p.sh., një kujtim i shkruar dhe një biografi mbi të njëjtin individ); - lidh informacionin e tekstit joletrar me dije nga lëndë të tjera ose me situata nga jeta reale; - dallon tiparet kryesore të një teksti joletrar (specifikisht të teksteve që janë përcaktuar te njohuritë); - lexon dhe kupton në mënyrë të pavarur tekste joletrare që përfaqësojnë larmi kulturash dhe këndvështrimesh, me një nivel kompleksiteti të përshtatshëm për të paktën klasën e 6-të. <i>Pasurimi i fjalorit</i> Nxënësi: - identifikon dhe shpjegon kuptimin e fjalëve të reja që has gjatë leximit të teksteve, duke përdorur kontekstin ose fjalorin; - përdor në fjali, fjalë dhe shprehje të reja të nxjerra nga tekstet e lexuara,.
Vlera dhe qëndrime Nxënësi: - tregon këmbëngulje dhe përkushtim gjatë leximit, edhe kur përballet me tekste të vështira ose të panjohura;	

- respekton mendimet dhe këndvështrimet e autorëve, duke u përpjekur të kuptojë qëllimin dhe mesazhin e tyre;
- vlerëson larminë e teksteve, duke lexuar me interes tekste të gjinive, tematikave dhe kulturave të ndryshme;
- shfaq kureshtje dhe dëshirë për të mësuar, duke kërkuar domethënien e fjalëve të reja dhe duke ndjekur temat që i interesojnë më tej;
- ndan me të tjerët përvojat e leximit, duke shprehur mendime dhe emocione mbi ato që ka lexuar, në mënyrë të argumentuar;
- respekton të drejtën e çdo lexuesi për të interpretuar një tekst ndryshe, duke pranuar shumëllojshmërinë e kuptimeve dhe të reagimeve;
- vlerëson ndikimin e leximit në formimin e tij personal, si dhe për të kuptuar veten, të tjerët dhe botën.

Krijimi i teksteve të ndryshme

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- planifikon, zhvillon ide, mbledh dhe organizon informacion për shkrimin e teksteve të ndryshme, duke përfshirë tekste digjitale dhe mediatike, me tematika të përshtatshme për moshën e tij;
- zbaton njohuritë rreth formave dhe gjinive të ndryshme të tekstit për të krijuar, për të rishikuar, për të redaktuar dhe për të korrigjuar tekstet e tij, si dhe reflekton në mënyrë kritike për tekstet e krijuara;
- zgjedh media, teknika dhe mjete të përshtatshme dhe efektive për të prezantuar tekstet dhe analizon në mënyrë kritike trajtimin e temave të ndryshme në tekste.

Njohuri

Aftësi

Disa nga tekstet që nxënësit mund të shkruajnë në klasën e 6-të, janë: - Tekste rrëfyese, si: tregime të thjeshta të trilluara ose të jetës reale, rrëfime personale ose ngjarje të përjetuara, përralla. - Tekste përshkruese, si përshkrim personash, vendesh, ngjarjesh ose objektivesh. - Tekste udhëzuese: udhëzime të ndryshme (si bëhet ose si përdoret diçka). Tekste informuese/shpjeguese, si p.sh., një ftesë. Disa tema sugjeruese për punët me shkrim në klasën e 6-të, janë: - Një ditë që nuk do ta harroj kurrë. - Udhëtimi më i bukur që kam bërë. - Një surprizë e papritur në klasë. - Një ditë si personazhi im i preferuar. - Dhoma ime (përshkrim). - Miku/mikja ime më i/e mirë. - Vendi që më pëlqen më shumë në lagjen time.	<i>Zhvillimi i ideve dhe organizimi i përmbajtjes</i> Nxënësi: - përcakton temën, qëllimin dhe lexuesin për tekstet që planifikon të krijojë dhe shpjegon pse forma, gjinia dhe mediumi i përzgjedhur i tekstit janë të përshtatshëm për qëllimin dhe lexuesin; - gjeneron dhe zhvillon ide për tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tij, duke përdorur strategji dhe burime të ndryshme, përfshirë edhe përvojat personale; - mbledh informacion dhe përmbajtje të rëndësishme për temën, duke përdorur burime të ndryshme tekstesh; përmbledh informacionin; verifikon besueshmërinë e burimeve; regjistron autorin dhe burimin e çdo materiali të marrë nga të tjerët; - rendit dhe organizon idetë dhe informacionin e mbledhur, duke përdorur strategji dhe mjete të përshtatshme, dhe përzgjedh përmbajtjen që lidhet me llojin e tekstit që do të krijojë; - shpjegon dhe krahason se si e kanë ndihmuar strategjitë dhe mjetet që ka përdorur për të shtjelluar idetë dhe për të organizuar përmbajtjen e teksteve, si dhe se si e kanë ndihmuar të përmirësohet gjatë krijimit të teksteve. <i>Krijimi i teksteve</i> Nxënësi: - harton projektet e teksteve të ndryshme, përfshirë tekste rrëfyese, shpjeguese dhe udhëzuese, duke përdorur mjete, media dhe strategji të ndryshme;
--	--

- Një ditë me shi. - Një pemë që kam mbjellë vetë. - Si të kujdesemi për një kafshë shtëpiake? - Si përgatitet ushqimi im i preferuar? - Si organizohet një festë në shkollë? - Çfarë mësova nga një libër që lexova? - Personazhi që më la më shumë mbresa. - Pse më pëlqeu ky libër?	- shkruan në mënyrë të rrjedhshme me shkrim dore dhe/ose përdor aftësitë bazë të shtypjes në tastierë (kompjuter), me saktësi dhe shpejtësi në rritje, për të përmirësuar saktësinë dhe cilësinë e tekstit; - përdor elemente stilistike për të shprehur mendimet, ndjenjat dhe opinionet për një temë, si dhe duke përdorur tonin e përshtatshëm sipas formës dhe gjinisë së tekstit; - përcakton këndvështrimin në tekstin e vet dhe shpjegon se si mesazhi i tij mund të kuptohet ndryshe nga lexues të ndryshëm që kanë këndvështrime të ndryshme; - bën ndryshime në përmbajtje, stil, strukturë dhe në elementet e tekstit të hartuar, duke shtuar apo duke hequr fjali për të përmirësuar qartësinë dhe koherencën; përdor strategji të ndryshme dhe merr parasysh komente apo sugjerime të mësuesit; - redakton tekstin për të përmirësuar saktësinë dhe stilin, duke kontrolluar për gabime në drejtshkrim, pikësim, gramatikë dhe formatim; redakton edhe tekste digjitale duke përdorur programe kompjuterike që ndihmojnë me kontrollin e drejtshkrimit dhe të gramatikës. <i>Prezantimi dhe reflektimi</i> Nxënësi: - përgatit tekstin përfundimtar, duke zgjedhur teknika dhe mjete të përshtatshme, përfshirë mjete digjitale për formatimin dhe përpunimin, për të arritur efektin e dëshiruar; - prezanton tekstin e krijuar, duke përdorur mediat dhe mjetet e përzgjedhura, dhe analizon se si e kanë ndihmuar këto zgjedhje për të komunikuar mesazhin e synuar; - përcakton hapat e ardhshëm për t'u përmirësuar si krijues tekstesh.
---	---

Vlera dhe qëndrime

Nxënësi:

- tregon kreativitet dhe imagjinatë, duke krijuar tekste origjinale që pasqyrojnë mendimet, ndjenjat dhe përvojat e tij;
- punon me përkushtim dhe kujdes, duke përmirësuar vazhdimisht tekstin përmes rishkrimit, korrigjimit dhe redaktimit;
- është i hapur ndaj komenteve dhe sugjerimeve për përmirësimin e shkrimit të tij dhe reflekton për to;
- tregon ndershmëri dhe origjinalitet, duke krijuar punime vetjake dhe duke shmangur çdo formë kopjimi;
- bashkëpunon me të tjerët, duke ndarë ide, duke dhënë dhe duke marrë komente gjatë procesit të krijimit të teksteve në grup;
- reflekton për zhvillimin e vet, duke analizuar pikat e forta dhe ato që kanë nevojë për përmirësim në shkrimet e veta.

Shënim. Vlerësimi i punëve me shkrim duhet të jetë i vazhduar dhe i shpërndarë gjatë gjithë vitit shkollor, duke përfshirë edhe fazat e procesit të shkrimit (*planifikimi, hartimi, rishikimi dhe redaktimi*). Sugjerohet që nxënësi të vlerësohet me notë në të paktën tri punë me shkrim gjatë vitit, ndërsa punët e tjera mund të vlerësohen nëpërmjet komenteve të mësuesit, vetëvlerësimit apo vlerësimit nga bashkëmoshatarët. Këto forma vlerësimi synojnë zhvillimin e aftësive të reflektimit, përmirësimit dhe përgjegjësisë së nxënësit për të nxënë.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- demonstroi njohuri dhe aftësi për gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta, për llojet e fjalive sipas kumtimit, pohimit dhe mohimit dhe sipas gjymtyrëve kryesore, për përdorimin e ligjëratës së drejtë dhe të ligjëratës së zhdrejtë, për klasat e fjalëve të ndryshueshme (kategoritë e tyre gramatikore) dhe të pandryshueshme, për përbërësit e fjalës dhe mënyrat e formimit të saj;
- njeh dhe zbaton rregullat drejtshkrimore, si dhe përdor drejt shenjat e pikësimit.

MORFOLOGJI

Sugjerohen 25 orë mësimi

Njohuri	Aftësi
- Klasat e fjalëve. - Klasat e fjalëve të ndryshueshme dhe të fjalëve të pandryshueshme.	Nxënësi: - dallon klasat e fjalëve në një fjali të dhënë; - argumenton pse një fjalë i përket një klase të caktuar, si p.sh., pse është emër ose pse është mbiemër; - klasifikon fjalët në fjalë të ndryshueshme dhe në fjalë të pandryshueshme duke argumentuar përgjigjen; - përdor, shton ose heq në fjali klase të ndryshme fjalësh, si p.sh., shton një mbiemër, folje, ndajfolje etj., kur i kërkohet.
Emri - Emrat e përveçëm dhe emrat e përgjithshëm. - Numri i emrit: numri shumës për emrat mashkullorë dhe për emrat femërorë. - Rasa e emrit. - Kategoria e shquarsisë dhe e pashquarsisë.	Nxënësi: - argumenton pse një emër është i përveçëm ose pse është i përgjithshëm; - përdor në fjali emra të përgjithshëm ose emra të përveçëm; - argumenton pse një emër është në numrin njëjës dhe pse është në numrin shumës; - përdor saktë në fjali emra në numrin njëjës dhe në numrin shumës, si dhe dallon ndryshimet në fjali, kur ndryshon numrin e emrit; - dallon format kryesore të shumësit të emrave mashkullorë dhe të emrave femërorë; - lakon emrat në të gjitha rasat; - përdor saktë emrat në rasën e duhur dhe argumenton pse një emër është në një rasë të caktuar;

	- dallon rastet kryesore të përdorimit të emrit në trajtë të pashquar dhe në trajtë të shquar.
Përemri - Llojet e përemrave. - Përemri dëftor. Kategoritë gramatikore të përemrit dëftor (gjini, numër dhe rasë). - Përemri pyetës i ndryshueshëm dhe i pandryshueshëm. Kategoritë gramatikore të përemrit pyetës (gjini, numër dhe rasë).	Nxënësi: - përcakton llojin e përemrave; - ndërton fjali me përemra të ndryshëm; - dallon dhe përdor drejt përemrat dëftorë; - përcakton kategoritë e gjinisë, të numrit dhe të rasës të përemrave dëftorë; - lakon përemrat dëftorë dhe ndërton fjali me ta; - krahason përemrat vetorë me përemrat dëftorë; - dallon përemrat pyetës dhe tregon pse përdoren ata; - dallon përemrat pyetës të ndryshueshëm nga përemrat pyetës të pandryshueshëm; - përdor saktë në fjali përemrin “<i>kush</i>” dhe “<i>cili/cila</i>”; - përcakton kategorinë e numrit, gjinisë dhe rasës së përemrave pyetës dhe i përdor në trajtën e duhur në fjali.
Folja - Mënyrat e foljes. - Foljet ndihmëse. - Mënyra dëftore dhe zgjedhimi i foljeve në kohët e saj. Zgjedhimi i parë. - Mënyra lidhore dhe zgjedhimi i foljeve në kohët e saj. Zgjedhimi i parë.	Nxënësi: - përcakton kur “<i>kam</i>” dhe “<i>jam</i>” janë si folje ndihmëse dhe kur janë folje dhe ndërton fjali me to; - përcakton kohën, numrin dhe vetën e foljeve të mënyrës dëftore dhe të mënyrës lidhore (<i>foljet e zgjedhimit të parë</i>), si dhe argumenton përgjigjen e tij; - përdor saktë në fjali foljet në mënyrën dëftore dhe foljet në mënyrën lidhore në të gjitha kohët e tyre; - ndryshon kohën e foljeve dhe përcakton ndryshimet kryesore që ndodhin në fjali.

Lidhëza - Lidhëzat bashkërenditëse, llojet. - Lidhëzat nënrenditëse.	Nxënësi: - përdor në fjali lidhëzat bashkërenditëse dhe lidhëzat nënrenditëse; - dallon dhe përdor në fjali llojet e lidhëzave bashkërenditëse, si dhe argumenton përgjigjen ose zgjedhjen e tij.
Parafjala - Parafjalët sipas rasave.	Nxënësi: - dallon parafjalët dhe i përdor ato në fjali para emrave, përemrave dhe numërorëve; - përcakton parafjalët sipas rasave.
Ndajfolja - Llojet e ndajfoljeve.	Nxënësi: - dallon kur një fjalë është ndajfolje; - krahason ndajfoljet nga klasat e tjera të fjalëve; - përcakton llojin e ndajfoljes dhe argumenton përgjigjen e tij; - përdor në fjali ndajfolje të llojeve të ndryshme.
FJALËFORMIM <i>Sugjerohen 8 orë mësimi</i>	
Njohuri	Aftësi
- Fjala dhe pjesët përbërëse të saj (rrënja, tema, parashtesa, prapashtesa dhe mbaresë). - Fjalët e prejardhura. - Parashtesat dhe prapashtesat që krijojnë fjalë të prejardhura.	Nxënësi: - dallon pjesët përbërëse të fjalës dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon parashtesat dhe prapashtesat kryesore të gjuhës shqipe në fjalë të prejardhura; - formon fjalë të prejardhura me parashtesat dhe prapashtesat e dhëna.

SINTAKSË

Sugjerohen 13 orë mësimi

Njohuri	Aftësi
- Fjalja e thjeshtë dhe fjalja e përbërë. - Gjymtyrët kryesore të fjalisë së thjeshtë. - Gjymtyrët e dyta të fjalisë (njohuri të përgjithshme). - Gjymtyrët e domosdoshme dhe jo të domosdoshme. - Kundrinori, me se shprehet. - Rrethanori, me se shprehet. - Përcaktori dhe llojet e tij.	Nxënësi: - dallon fjalinë e thjeshtë dhe fjalinë e përbërë; - përcakton funksionet sintaksore të fjalëve dhe të grupeve të fjalëve në një fjali; - dallon ndryshimin mes klasës së fjalës dhe funksionit; - dallon në fjali kryefjalën e shprehur me emër, përemër, numëror, grup emëror etj.; - ndërton fjali me kryefjalë që janë të shprehura me emra, përemra, grup emëror etj.; - dallon përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën; - përcakton në fjali kallëzuesin dhe ndërton fjali me të; - argumenton pse një gjymtyrë fjalie është e domosdoshme ose jo e domosdoshme; - gjen dhe përdor në fjali kundrinorin; - argumenton pse një gjymtyrë fjalie është kundrinor; - gjen dhe përdor në fjali rrethanorin dhe mënyrat e shprehjes së tij; - argumenton pse një gjymtyrë fjalie është rrethanor; - gjen llojet e përcaktorit dhe mënyrat e shprehjes së tij; - argumenton pse një gjymtyrë fjalie është përcaktor.

DREJTSHKRIM

Sugjerohen 10 orë mësimi

Njohuri	Aftësi
---------	--------

- Përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe (titujt e librave, të revistave, të gazetave etj.). - Drejtshkrimi i fjalëve që e kanë zanoren <i>e</i> në pozicione të ndryshme. - Drejtshkrimi i fjalëve që e kanë zanoren <i>ë</i> në pozicione të ndryshme. - Drejtshkrimi i lidhëzave. - Drejtshkrimi i paraafjalëve. - Drejtshkrimi i ndajfoljeve.	Nxënësi: - përdor drejt shkronjën e madhe; - shkruan drejt zanoret <i>e</i> dhe <i>ë</i> në pozicione të ndryshme; - shkruan drejt fjalët e prejardhura me prapashtesat <i>-si, -ri, -ar, -tar, tor, -shëm</i> etj.; - shkruan drejt lidhëzat; - shkruan drejt paraafjalët; - shkruan drejt ndajfoljet.
LESIKOLOGJI DHE SEMANTIKE <i>Sugjerohen 4 orë mësimi</i>	
Njohuri	Aftësi
- Fusha leksikore e fjalëve (njohuri të përgjithshme). - Familja e fjalëve (njohuri të përgjithshme).	Nxënësi: - përcakton fushën leksikore të fjalëve; - krijon familje fjalësh.
Vlera dhe qëndrime Nxënësi: - tregon vëmendje dhe saktësi në zbatimin e rregullave të gjuhës shqipe në të gjitha format e komunikimit, të shkruar dhe të folur; - tregon këmbëngulje për të përmirësuar përdorimin e gjuhës, duke korrigjuar gabimet dhe duke kërkuar kuptimin e fjalëve apo të trajtave që nuk i njeh; - vlerëson pasurinë e gjuhës shqipe, duke përdorur fjalë të reja, sinonime, shprehje dhe ndërtime gjuhësore të larmishme;	

- demonstroi kureshtje gjuhësore, duke pyetur, duke eksploruar dhe duke kërkuar të kuptojë funksionin e fjalëve, mënyrat e ndërtimit të tyre dhe përdorimin në fjali;
- bashkëpunon me të tjerët për të sqaruar dhe për të përvetësuar rregulla gjuhësore, duke ndarë njohuri, duke pyetur dhe duke dhënë ndihmë;
- fillon të kuptojë se gjuha shqipe është pjesë e identitetit të tij personal dhe kulturor, dhe përpiqet ta ruajë dhe ta zhvillojë këtë pasuri.

5.3. Shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).

Në këtë rubrikë ofrohen disa shembuj orientues veprimtarish që ndihmojnë për të përmbushur një rezultat të nxëni. Shembujt synojnë të ilustrojnë se si mund të realizohen aftësitë dhe rezultatet në procesin mësimor. Për hartimin e rezultateve të të nxënit për orë mësimore, mësuesi bazohet në aftësitë e programit. Dallimi mes aftësisë dhe rezultatit të të nxënit është:

- Aftësia është një deklaratë e përgjithshme që tregon çfarë duhet të zhvillojë nxënësi gjatë një periudhe (grupi orësh, muaji, periudhe, viti, niveli). Pra, aftësia është e gjerë dhe afatgjatë (pasi kërkon kohë dhe sprova të vazhdueshme për t'u arritur), përshkruan sjelljen e synuar (p.sh., të tregojë një ngjarje nga jeta reale duke respektuar rendin kronologjik). Një shembull aftësie është: *Nxënësi shkruan një tekst rrëfyes të thjeshtë, duke ndjekur rendin logjik të ngjarjeve.*
- Rezultati i të nxënit për një orë mësimore është një deklaratë konkrete dhe e matshme që tregon çfarë do të arrijë nxënësi në fund të asaj ore mësimore. Ai është i ngushtë dhe i përqendruar në një qëllim specifik, i matshëm, që mund të verifikohet brenda një ore, dhe bazohet në një pjesë të aftësisë së madhe nga programi lëndor. Rezultatet e të nxënit hartohen nga mësuesi. Shembull: *Nxënësi rrëfen me hollësi një ngjarje nga një ekskursion, duke ndjekur rendin kronologjik.*

Rezultati i të nxënit	Veprimtaritë
<i>Nxënësi rrëfen me hollësi një ngjarje nga një</i>	Aktivizimi i përvojës dhe ideve të nxënësve - Mësuesi pyet: <i>Kujtoni një ekskursion që keni bërë. Çfarë ju ka mbetur në mendje?</i> - Nxënësit ndajnë një moment të shkurtër me shokun e bankës.

<i>ekskursion, duke ndjekur rendin kronologjik.</i>	- Në tabelë shkruhen fjalë kyç: <i>autobusi, shëtitja, emocionet, surpriza, lodhja</i> etj. <i>Ndërtimi i strukturës së tregimit</i> - Mësuesi prezanton një model të shkurtër rrëfimi për një ekskursion (tekst me fillim, zhvillim dhe përfundim). - Diskutim rreth strukturës: <i>Kur ndodhi? Me kë ishte? Çfarë ndodhi fillimisht? Pastaj? Si përfundoi?</i> - Nxënësit plotësojnë një fletë pune me këto tri ndarje: ☞ Në fillim... ☞ Pastaj... ☞ Në fund... <i>Përdorimi i hollësive përshkruese</i> - Mësuesi prezanton disa fjali (me dhe pa hollësi përshkruese) dhe pyet: <i>Cila është më interesante për t'u lexuar dhe pse?</i> - Shembull: “Ishim në një vend të bukur.” Apo “Zbritëm nga autobusi përballë një lugine me gjelbërim dhe erë të freskët bari.” - Nxënësit plotësojnë një tabelë me tri kolona: ☞ <i>Çfarë pashë?</i> ☞ <i>Çfarë dëgjova?</i> ☞ <i>Çfarë ndjeva?</i> <i>Shkrimi i tregimit</i> - Nxënësit përdorin fletën e punës për të shkruar tregimin e tyre. - Mësuesi u kujton që të përdorin fjalët, si: <i>së pari, më vonë, në fund</i>, si dhe mbiemra të përshtatshëm. <i>Leximi dhe ndarja</i>
--	---

	- Disa nxënës lexojnë tregimin e tyre para klasës. - Mësuesi ose shokët e klasës bëjnë komente pozitive dhe sugjerime sipas kriterëve: ☞ <i>A kishte rend kronologjik?</i> ☞ <i>A kishte përshkrime që e bënin ngjarjen interesante?</i>
--	---

Shënim. Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjuhës shqipe do të përshkruhen veprimtari praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Mësimdhënia e gjuhës shqipe bazohet në qasjen për zhvillimin e kompetencave gjuhësore dhe të kompetencave kyç të nxënësve. Në këtë rubrikë përshkruhen parimet, strategjitë dhe metodat që udhëheqin procesin e mësimdhënies.

Parimet e mësimdhënies së gjuhës shqipe

Që mësimdhënia e gjuhës shqipe të jetë e suksesshme, mësuesi duhet të ndjekë disa parime, si:

Kontekstualizimi nënkupton mësimdhënien e gjuhës duke krijuar detyra dhe veprimtari që lidhen drejtpërdrejt me situata reale dhe kuptimplota, në mënyrë që nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre gjuhësore në kontekste autentike. Kjo përfshin përdorimin e teksteve dhe të temave që reflektojnë dhe lidhen me jetën e përditshme, me kulturën dhe me përvojat personale të nxënësve, duke nxitur gjithashtu përdorimin e saktë dhe të përshtatshëm të rregullave gramatikore, si dhe pasurimin e fjalorit si në të folur ashtu edhe në të shkruar. Për shembull, një mësues mund të përdorë një artikull gazete për të diskutuar një ngjarje aktuale ose një tekst letrar për të nxitur një debat rreth çështjeve shoqërore.

Integrimi nënkupton mësimdhënien e kompetencave receptive (të dëgjuarit dhe të lexuarit), kompetencave produktive (të folurit dhe të shkruarit), kompetencave gramatikore, drejtshkrimore etj., në mënyrë të ndërlidhur, ku secila kompetencë ose aftësi mbështetet tek tjetra, duke përdorur tekste të ndryshme, letrare ose jo letrare, mediatike dhe online, për të ofruar perspektiva të ndryshme dhe lidhje kuptimplota në përdorimin e gjuhës shqipe.

Mësimdhënia me nxënësin në qendër përqendrohet në nevojat, interesat dhe nivelet e gatishmërisë së nxënësve, duke i vendosur ata në qendër të procesit mësimor. Kjo kërkon që mësuesi të përshtatë metodat dhe materialet mësimore për të përfshirë të gjithë nxënësit në mënyrë aktive, duke i motivuar ata për të zhvilluar aftësitë gjuhësore dhe për të arritur potencialin e tyre maksimal.

Orientimi drejt procesit nënkupton që mësuesi modelon dhe mbështet proceset e të nxënësve, me synim zhvillimin e aftësive gjuhësore dhe të njohurive rreth gjuhës. Mësuesi i ndihmon nxënësit të kuptojnë dhe të praktikojnë hapat e nevojshëm për të hartuar tekste të folura, të shkruara, mediatike dhe digjitale. Për shembull, në shkrimin e një eseje, mësuesi mund të fillojë me modelimin e procesit të projektimit të ideve, pastaj të mbështesë nxënësit në strukturimin e fjalive dhe në organizimin e paragrafëve, dhe në fund t'i udhëzojë ata në rishikimin dhe në redaktimin për të përmirësuar cilësinë e produktit përfundimtar.

Mësimdhënia ndërvepruese nënkupton krijimin e një mjedisi të pasur dhe të përgjegjshëm për komunikim. Ky parim mbështet në mënyrë të qartë zhvillimin e aftësive të komunikimit. Ndërveprimi përfshin në mënyrë aktive nxënësit, duke nxitur pjesëmarrjen, bashkëpunimin dhe rritjen e vetëbesimit në përdorimin e gjuhës. Gjithashtu, ai ndikon në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive mes nxënësve dhe mësuesit, duke krijuar një atmosferë mbështetëse dhe të hapur për të nxënësve. Kjo mund të arrihet duke ndërtuar besim mes nxënësve, duke vendosur pritshmëri të qarta dhe rutina të qëndrueshme, si dhe duke mbajtur një disiplinë pozitive që inkurajon sjellje të drejta dhe të përshtatshme.

Zhvillimi spiral arrihet kur mësuesi mëson, rishikon dhe rikthehet vazhdimisht tek aftësitë, njohuritë gramatikore dhe format e ndryshme të teksteve, duke i prezantuar ato në nivele të ndryshme vështirësie dhe kompleksiteti. Kjo qasje lejon që njohuritë dhe aftësitë e nxënësve të zhvillohen gradualisht dhe të forcohen me kalimin e kohës, duke ndërtuar mbi bazën e asaj që është mësuar më parë për të arritur një nivel më të lartë të kompetencës gjuhësore.

Gjithëpërfshirja është një parim i rëndësishëm që ndikon në të gjitha aspektet e jetës shkollore. Gjithëpërfshirja krijon një klimë shkollore që inkurajon të gjithë nxënësit të punojnë për të arritur sukses, forcon ndjenjën e vlerësimit për çdo nxënësi dhe ndihmon në zhvillimin e një identiteti të fortë dhe një imazhi pozitiv për veten. Gjithashtu, nxit stafin pedagogjik dhe nxënësit të vlerësojnë dhe të respektojnë diversitetin në shkollë dhe në shoqërinë e gjerë. Gjithëpërfshirja në shkollë promovon barazinë, marrëdhëniet e shëndetshme dhe qytetarinë aktive e të përgjegjshme. Në mungesë të qasjeve gjithëpërfshirëse në arsim, krijohen mjedise diskriminuese.

Mësuesi mund të krijojë mundësi të shumta për nxënësit që të mësojnë rreth diversitetit dhe perspektivave të ndryshme. Duke vënë në dukje kontributet dhe perspektivat e grupeve historikisht të marginalizuara dhe duke krijuar hapësira ku përvojat e tyre mund të vlerësohen dhe të konfirmohen, mësuesi mund të ndihmojë që nxënësit me prejardhje ose përkatësi të ndryshme të ndihen të përfaqësuar në procesin mësimor. Është e rëndësishme që aktivitetet mësimore dhe materialet që përdoren për zbatimin e programit, të reflektojnë diversitetin e shoqërisë shqiptare. Përveç kësaj, mësuesit duhet të diferencojnë qasjet e tyre në mësimdhënie dhe vlerësim, duke marrë parasysh prejardhjen, përvojat, interesat, aftësitë dhe nevojat mësimore të të gjithë nxënësve.

6.1. Metodatat dhe teknikat mësimore për zhvillimin e kompetencave gjuhësore

Përmbushja e qëllimeve të programit mësimor kërkon nga mësuesi që të përzgjedhë metodatat dhe teknikat e duhura për të zhvilluar kompetencat gjuhësore: të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit. Ato ndihmojnë mësuesin të krijojë mjedise të pasura dhe të larmishme të nxëni, duke siguruar që nxënësit të përmbushin rezultatet e të nxënit.

Në tabelën e mëposhtme sugjerohen disa metoda dhe teknika mësimore që mbështesin zhvillimin e kompetencave gjuhësore.

Metoda / teknika	Të dëgjuarit	Të folurit	Të lexuarit	Të shkruarit
Stuhi mendimi	X	X		
Lexim i drejtuar		X	X	
Dëgjim i drejtuar (DLTA)	X	X		
Parashikim me terma paraprakë		X	X	
Alfabeti i njëpasnjëshëm i tryezës së rrumbullakët		X		X
Lojë me role	X	X		
Rrjeti i diskutimit	X	X		
Kllaster (Pema e mendimeve)		X	X	

Diagrami i Venit			X	X
Harta e konceptit			X	X
INSERT	X			X
Di/Dua të di/Mësova më shumë		X	X	X
Harta e mendjes	X		X	X
Pema e problemit	X		X	X
Pesëvargëshi	X		X	
Diagrami piramidal			X	X
Ditari dypjesësh	X			X
Diktimi				X
Kubimi	X		X	
Ruaje fjalën e fundit për mua	X		X	
Korniza të skeletëzuara të mësimi			X	X
Karrigia e nxehtë	X	X		
Imagjinata e drejtuar	X		X	
Dallimi i fakteve dhe i opinioneve	X	X	X	
Gjashtë kapelat për të menduarit	X			X
Shkrimi krijues me kufizime				X
Çfarë..., nëse...	X		X	
Tregimi pamor	X			X
Debati	X	X		

Zbatimi i këtyre teknikave dhe metodave mësimore zhvillojnë te nxënësit kompetencat gjuhësore dhe disa aftësi që janë pjesë e tyre, si:

- të njohin, të kuptojnë, të analizojnë, të krahasojnë, të kategorizojnë, të vlerësojnë dhe të parashikojnë;
- të shtrojnë pyetje të të menduarit të nivelit të lartë;
- të mbledhin fakte nga burime të besueshme;
- të shprehin mendimin e tyre duke përdorur argumente;
- të marrin parasysh perspektivat e tjera;
- të zgjidhin probleme;
- të mendojnë në mënyrë krijuese;
- të identifikojnë dhe të analizojnë shkaqet dhe pasojat;
- të dallojnë faktet dhe opinionet;
- të mendojnë në mënyrë të pavarur;
- të marrin vendime bazuar në dëshmi;
- etj.

6.2. Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e gjuhës shqipe

Projektet kurrikulare janë veprimtari të strukturuar mësimore që synojnë të zhvillojnë kompetencat kyç dhe kompetencat gjuhësore të nxënësve përmes detyrave të integruara që kërkojnë bashkëpunim, hulumtim dhe krijimtari. Ato mund të jenë lëndore ose ndërlëndore që përfshijnë njohuri dhe aftësi nga fusha dhe lëndë të tjera. Projektet shpesh lidhen me situata reale nga jeta e përditshme e shkollës dhe e komunitetit dhe mund të përdoren për të zgjidhur probleme konkrete ose për të përmbushur nevoja të veçanta të nxënësve dhe të komunitetit të tyre.

Rëndësia e projekteve kurrikulare në lëndën e gjuhës shqipe

- *Zhvillimi i kompetencave gjuhësore*: Nxënësit përmirësojnë aftësitë në të folur, të dëgjuar, të lexuar dhe të shkruar përmes detyrave dhe veprimtarive praktike.
- *Zhvillimi i mendimit kritik dhe krijues*: Nxënësit mësojnë të analizojnë, të vlerësojnë dhe të krijojnë ide të reja përmes projekteve që kërkojnë zgjidhje problemesh dhe mendim kritik.
- *Zhvillimi i aftësive për të punuar në mënyrë të pavarur*: Nxënësit inkurajohen të marrin përgjegjësi për të nxënësit e tyre dhe të krijojnë vetëbesim në aftësitë e tyre.
- *Përfshirja aktive dhe bashkëpunimi*: Nxënësit ndërveprojnë dhe angazhohen duke punuar në grupe dhe duke ndarë ide.
- *Integrimi i njohurive dhe i aftësive*: Nxënësit krijojnë lidhje midis teorisë dhe praktikës, pasi zbatojnë njohuritë e tyre në situata reale të jetës së përditshme.
- *Zgjidhja e problemeve reale*: Nxënësit mësojnë të kuptojnë dhe të trajtojnë sfida të ndryshme që lidhen me shkollën, komunitetin dhe shoqërinë.
- *Zhvillimi i aftësive për kërkim dhe prezantim*: Nxënësit aftësohen të kërkojnë informacion, të organizojnë të dhëna dhe të prezantojnë gjetjet e tyre në mënyrë të qartë dhe bindëse.

Disa shembuj projektesh në gjuhën shqipe mund të jenë: hartimi i një reviste që përfshin artikuj, intervista dhe përshkrime për tema me interes për nxënësit, duke zhvilluar aftësitë e tyre të shkrimit dhe redaktimit; organizimi i një shfaqjeje të shkurtër teatrale bazuar në një vepër letrare ose në një ngjarje lokale, që ndihmon në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe interpretuese; krijimi i *blogjeve* ose *podcast-eve* për të ndarë mendimet dhe përvojat personale në gjuhën shqipe, duke forcuar aftësitë e të folurit dhe të shkruarit; organizimi i ekspozitave me tema kulturore, duke përfshirë histori familjare, tradita dhe veshje popullore, që zhvillojnë aftësitë kërkimore dhe prezantuese; realizimi i dokumentarëve ose i videove që trajtojnë tema të rëndësishme për kombin shqiptar, duke përdorur teknologji dhe media të ndryshme për të përmirësuar aftësitë multimediale.

6.3. Bisedat letrare

Bisedat letrare janë diskutime të udhëhequra ose të strukturuar, në të cilat nxënësit shprehin mendimet dhe ndjesitë e tyre rreth një vepre letrare të lexuar në kohën e lirë ose në shtëpi, jashtë orarit të rregullt mësimor. Mund të jenë tregime, romane, poezi, fabula, ese etj. Bisedat letrare janë të rëndësishme, pasi nxënësit:

- zhvillojnë shprehitë e leximit të pavarur dhe të vazhdueshëm;
- pasurojnë botën emocionale dhe përfitojnë kënaqësi estetike;
- nxisin aftësitë për të dëgjuar dhe për të argumentuar;
- zhvillojnë aftësitë e mendimit kritik;
- shprehin veten lirshëm dhe ndajnë përvojat letrare me të tjerët.

Përgjatë një viti shkollor *sugjerohen* së paku *tri deri në katër* biseda letrare, të shpërndara në periudha të ndryshme dhe duke bërë një përgatitje të mëparshme me tekstin e lexuar. Tekstet duhet të jenë:

- të përshtatshme për moshën e nxënësve dhe nivelin e klasës;
- të kenë vlerë letrare, estetike, emocionale dhe/ose morale;
- të jenë të kuptueshme dhe të pasura në përmbajtje;
- të nxisin pyetje, reagime dhe diskutime;
- të pasqyrojnë tema të afërta me përvojat e nxënësve;
- të përfaqësojnë larmi gjinish, periudhash, autorësh, përfshirë shqiptarë dhe të huaj.

6.4. Lexuesi i shekullit XXI

Në shekullin XXI, leximi nuk është më një aktivitet i izoluar, i kufizuar vetëm te libri i shtypur dhe përjetimi individual i tekstit. Sot, nxënësi-lexues jeton në një botë të mbushur me informacion, ku tekstet qarkullojnë përmes mediumeve të ndryshme: librave, pajisjeve digjitale, rrjeteve

sociale dhe materialele multimediale. Ai nuk është më thjesht një marrës pasiv i përmbajtjes, por një pjesëmarrës aktiv sepse analizon, reflekton, komenton, ndan dhe krijon kuptim në bashkëbisedim me të tjerët.

Në këtë realitet të ri, programi dhe mësimdhënia e gjuhës shqipe duket t'u krijojnë mundësi nxënësve të zhvillojnë aftësi jo vetëm për të kuptuar tekstin e shkruar, por edhe për të lundruar mes llojeve të ndryshme të teksteve (letrare dhe jolettrare, të shtypura dhe digjitale), për të zhvilluar mendimin kritik dhe për të mbajtur qëndrim ndaj ndikimit të mediave. Formimi i një lexuesi të aftë, reflektues dhe të vetëdijshëm është një nga qëllimet kryesore të lëndës së gjuhës shqipe.

Tiparet e lexuesit të shekullit XXI

Lexuesi i shekullit XXI rritet dhe formësohet brenda një bote digjitale, të ndërlidhur dhe shumëkulturore. Ai nuk është më thjesht një konsumues i librave të shtypur, por një përdorues i shumëfishtë i burimeve të ndryshme të informacionit.

Sot, lexuesi ndërthur leximin tradicional me forma të reja: libra elektronikë, audiolibra, artikuj online, *blogje*, rrjete sociale dhe platforma multimediale. Ai lëviz natyrshëm mes gjuhëve të ndryshme, kulturave dhe gjinive, duke pasuruar përvojën e vet të leximit me ndikime globale dhe ndërkulturore.

Një nga tiparet më dalluese është *aftësia për të ndërvepruar* me tekstin. Lexuesi i shekullit XXI e sheh tekstin si një hapësirë për diskutim, jo si të vërtetë absolute. Përmes komenteve online, *blogjeve*, rishikimeve dhe rrjeteve sociale, ai bëhet pjesë aktive e qarkullimit të ideve. Në të njëjtën kohë, lexuesi i shekullit XXI është shpesh i shpërqendruar, i mësuar me lexime të shpejta dhe të fragmentuara. Titujt, përmbledhjet dhe lajmet e shkurtra marrin më shumë vëmendje sesa tekstet e gjata e të thelluara, duke krijuar sfida për zhvillimin e aftësisë së leximit të thellë dhe reflektues. Ky lexues është gjithashtu një kërkues i përvojave personale: ai lexon jo vetëm për informim apo argëtim, por edhe për zhvillim personal, mirëqenie emocionale dhe kuptim të vetes. Librat motivues, historitë e vërteta dhe rrëfimet personale zënë një vend të rëndësishëm në leximet e tij.

Në aspektin edukativ, lexuesi i sotëm e konsideron leximin si pjesë të të nxënës gjatë gjithë jetës. Ai kërkon të përmirësojë aftësitë e veta profesionale, të qëndrojë i përditësuar me zhvillimet e reja dhe të zgjerojë horizontet e veta përmes leximit.

Një element jetik është ndërgjegjësimi për ndikimin mediatik: lexuesi i shekullit XXI ka nevojë të dallojë informacionin e vërtetë nga lajmet e rreme, të zhvillojë mendimin kritik dhe të jetë një përdorues i kujdesshëm i burimeve.

6.5. Puna me nxënësit me aftësi të kufizuara në lëndën e gjuhës shqipe

Puna me nxënësit me aftësi të kufizuara kërkon një mësimdhënie të diferencuar dhe gjithëpërfshirëse, që merr parasysh nevojat specifike të çdo nxënësi. Kjo punë nis me njohjen e specifikave të nxënësit dhe me hartimin e planit edukativ individual (PEI), në bashkëpunim me mësuesin ndihmës, psikologun, stafin e shkollës dhe/ose të qendrës burimore etj. Në lëndën e gjuhës shqipe, kjo nënkupton përdorimin e metodave, teknikave dhe strategjive të përshtatura për zhvillimin e aftësive gjuhësore, komunikimit dhe ndërveprimit në mënyrë të kuptueshme dhe të arritshme për çdo nxënë. Disa prej tyre janë:

- *Përshtatja e materialeve mësimore*, përfshirë materiale me shkronja të mëdha, tekste të thjeshtuara, burime audio dhe vizuale.
- *Zgjedhja e detyrave të diferencuara* që përputhen me nivelin e aftësive të nxënësve dhe me stilet e tyre të të nxënit.
- *Krijimi i një mjedisi mbështetës* që inkurajon pjesëmarrjen aktive dhe vetëbesimin e nxënësve.
- *Integrimi i pajisjeve dhe i aplikacioneve digjitale* që ndihmojnë në përmirësimin e aksesit në materiale dhe në komunikim.
- *Integrimi i videove, imazheve dhe regjistrimeve zanore* për të përmirësuar kuptimin dhe përfshirjen e nxënësve.
- *Përdorimi i metodave shumëshqisore* që përfshijnë dëgjimin, shikimin dhe prekjen për të lehtësuar të nxënit.
- *Përdorimi i shembujve konkretë dhe të thjeshtë dhe i përvojave praktike* për të mundësuar të kuptuarit e njohurive dhe të aftësive gjuhësore.
- *Ndihma e bashkëmoshatarëve* nëpërmjet përfshirjes së nxënësve në punë në grupe të vogla për të nxitur bashkëpunimin dhe ndërveprimin.

Disa shembuj veprimtarish për nxënësit me aftësi të kufizuara në lëndën e gjuhës shqipe janë:

- Diskutime të thjeshta, lojëra me role, përshkrimi i fotografive dhe përdorimi i kartave me fjalë për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive të të folurit.
- Dëgjimi i tregimeve të thjeshta, *podcast*-eve ose regjistrimeve zanore, me pyetje të lehta për të kuptuar mesazhin kryesor.
- Leximi i teksteve (të shtypura) të thjeshta, me figura dhe me shkronja të mëdha ose leximi i teksteve digjitale.
- Shkrimi i fjalëve të thjeshta, përgatitja e përshkrimeve të shkurtra dhe përdorimi i aplikacioneve për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive të shkrimit.

6.6. Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjuhës shqipe

Nxënësit e talentuar përbëjnë një grup të veçantë, me aftësi të theksuara në të menduarit kritik, analizën gjuhësore dhe krijimin letrar. Përfshirja dhe mbështetja e nxënësve të talentuar në procesin mësimor është e rëndësishme jo vetëm për zhvillimin e talentit të tyre, por edhe për krijimin e një klime mësimore sfiduese dhe frymëzuese për të gjithë klasën. Mësuesit duhet të krijojnë mundësi për nxënësit e talentuar që të zgjerojnë dhe të thellojnë njohuritë e tyre, të shprehin kreativitetin dhe të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë. Puna me ta është e rëndësishme, pasi:

- nxënësit e talentuar kanë nevojë për sfida dhe përmbajtje të avancuar që përputhen me aftësitë e tyre për të arritur rezultate të larta;
- përfshirja e nxënësve të talentuar në veprimtari komplekse dhe sfiduese rrit motivimin dhe angazhimin e tyre në procesin mësimor;
- këta nxënës shpesh kanë potencialin për të udhëhequr grupe dhe për të ndikuar pozitivisht në mjedisin e klasës;
- nxënësit e talentuar marrin pjesë në konkurse, olimpiada dhe projekte që përfundojnë me arritje jo vetëm për ta, por edhe për mësuesit dhe shkollën.

Si mund të identifikohen nxënësit e talentuar?

- Kanë rezultate të shkëlqyera në teste, ese, punë me shkrim, projekte etj.
- Përvetësojnë shpejt konceptet dhe kanë aftësi për të lidhur njohuritë në mënyra krijuese.
- Kanë aftësi të theksuara për të analizuar dhe për të interpretuar tekstet dhe situatat gjuhësore.
- Kanë kreativitet dhe origjinalitet në shprehje.
- Shprehin interes dhe kuriozitet të vazhdueshëm për të lexuar, për të shkruar dhe për të eksploruar tema komplekse.

Si mund të punohet me nxënësit e talentuar?

- Dhënia e detyrave të avancuara dhe komplekse që kërkojnë mendim kritik dhe krijues.
- Përfshirja në projekte që kërkojnë udhëheqje dhe përgjegjësi më të larta.
- Përfshirja në debate, konkurse dhe prezantime publike për të ndarë njohuritë dhe talentin me të tjerët.
- Integrimi i platformave online dhe i burimeve digjitale për të zgjeruar njohuritë.

- Analiza të thelluara të veprave letrare, interpretimi i mesazheve të fshehura dhe krijimi i eseve dhe i tregimeve me përmbajtje origjinale.
- Organizimi i takimeve për të diskutuar për librat dhe për të ndarë mendime për autorët dhe krijimtarinë e tyre letrare.
- Nxitja për të marrë pjesë në konkurse letrare, festivale poetike, olimpiada dhe projekte që sjellin risi.

Shënim. Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjuhës shqipe do të përshkruhen me hollësi veprimtari praktike për zbatimin e metodave të mësimdhënies.

VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe është pjesë e rëndësishme e procesit mësimor. Ai ndihmon mësuesin të kuptojë se sa mirë po përvetësojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë që lidhen me kompetencat gjuhësore dhe me kompetencat kyç. Qëllimi i vlerësimit nuk është vetëm të vendosë një notë, por:

- të ndihmojë nxënësin të kuptojë progresin e tij, të mësojë nga gabimet, të përmirësojë të shprehurin dhe komunikimin e tij me gojë dhe me shkrim;
- t'i mundësojë nxënësit të reflektojë për mënyrën si kupton dhe krijon tekste;
- të ndihmojë mësuesin të përshtatë metodat e mësimdhënies sipas nevojave dhe ritmit të klasës;
- të forcojë aftësinë e nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, për të interpretuar, për të krijuar tekste të ndryshme etj.

7.1. Parimet e vlerësimit në lëndën e gjuhës shqipe

Vlerësimi në lëndën e gjuhës shqipe udhëhiqet nga një sërë parimesh që synojnë të mbështesin të nxënësit e nxënësit, të sigurojnë drejtësi dhe përfshirje, si dhe të përmirësojnë vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies. Disa nga këto parime janë:

- *Vlerësimi mbështet të nxënësit:* Vlerësimi nuk ka vetëm funksion matës, por shërben si mjet për të përmirësuar të nxënësit e nxënësit dhe për të zhvilluar kompetencat gjuhësore.

- *Vlerësimi është i vazhdueshëm dhe i integruar në mësim:* Vlerësimi realizohet në mënyrë të natyrshme gjatë gjithë procesit mësimor, në çdo aktivitet leximi, të foluri, dëgjimi apo shkrimi.
- *Vlerësimi bazohet në kompetencat e lëndës:* Vlerësimi mat jo vetëm njohuritë gjuhësore, por edhe aftësinë për të kuptuar, për të analizuar, për të interpretuar, për të gjykuar dhe për të krijuar tekste të ndryshme, për të shprehur mendime, ndjenja dhe qëndrime në mënyrë të qartë dhe të përshtatshme.
- *Vlerësimi është i drejtë dhe gjithëpërfshirës:* Vlerësimi merr parasysh ritmet dhe nevojat e ndryshme të nxënësve, stilin e të nxënit, nivelin gjuhësor individual, duke promovuar barazi dhe përfshirje.
- *Vlerësimi është i kuptueshëm dhe i shpjegueshëm për nxënësin:* Nxënësi duhet të dijë qartë çfarë pritet prej tij, si do të vlerësohet dhe për çfarë do të marrë vlerësim.
- *Vlerësimi nxit reflektimin dhe vetëvlerësimin:* Nxënësi përfshihet në procesin e vlerësimit, mëson të analizojë punën e vet, të vë në dukje pikat e forta dhe aspektet për përmirësim.
- *Vlerësimi përdor teknika dhe instrumente të larmishme:* Vlerësimi realizohet përmes teknikave të ndryshme: vëzhgim, prezantime, punë me shkrim, diskutime, projekte, vetëvlerësim dhe vlerësim nga bashkëmoshatarët.
- *Vlerësimi udhëzon mësuesin në përmirësimin e mësimdhënies:* Vlerësimi i jep informacion mësuesit për të reflektuar për metodat e përdorura, për të identifikuar vështirësitë e nxënësve dhe për të planifikuar ndërhyrje të përshtatura.

7.2. Llojet e vlerësimit në lëndën e gjuhës shqipe

Llojet e vlerësimit që mund të zbatohen në lëndën e gjuhës shqipe, janë:

a) *Vlerësimi për të nxënë*

Vlerësimi për të nxënë ose formues është vlerësimi që kryhet gjatë procesit të mësimdhënies për të monitoruar progresin e nxënësve dhe për t'i ndihmuar ata të përmirësohen. Qëllimi i këtij lloji vlerësimi nuk është vendosja e notave, por ofrimi i udhëzimeve për zhvillimin e mëtejshëm të nxënësve. Nëse përdoret siç duhet, vlerësimi për të nxënë përmirëson cilësinë e mësimdhënies dhe ndihmon nxënësit të arrijnë potencialin e tyre maksimal.

Qëllimet e vlerësimit për të nxënë janë:

- Zbulon boshllëqet në njohuri dhe aftësi, duke ndihmuar mësuesin të përshtatë metodat dhe teknikat mësimore.
- Ndihmon nxënësit të kuptojnë gabimet e tyre dhe të mësojnë prej tyre, duke i bërë më të vetëdijshëm për përparimin e tyre.
- Ofron të dhëna të vlefshme për mësuesin që të modifikojë metodat e tij të mësimdhënies në mënyrë që të jenë më efektive.
- Kur nxënësit marrin komente dhe vlerësime të menjëhershme dhe konstruktive, ata ndihen më të inkurajuar për të përmirësuar arritjet e tyre.
- Ndihmon nxënësit të analizojnë dhe të vlerësojnë progresin e tyre, duke i bërë më të pavarur në të nxënit.
- I ndihmon nxënësit të kuptojnë kriteret e suksesit dhe të mësojnë nga njëri-tjetri.

Më poshtë jepen disa teknika të vlerësimit për të nxënë:

- Vlerësimi në proces gjatë hartimit të punëve me shkrim (teksteve).
- Pyetje gjatë orës së mësimi për të kontrolluar kuptimin.
- Detyra të shkurtra për të vlerësuar njohuritë e fituara.
- Vetëvlerësime nga nxënësit.
- Vëzhgime dhe diskutime të udhëhequra nga mësuesi.
- Komente të detajuara dhe konstruktive në vend të notave.

b) Vlerësimi i të nxënit

Vlerësimi i të nxënit është një lloj vlerësimi që kryhet në fund të një grupi orësh ose të një periudhe mësimore për të matur dhe për të vlerësuar arritjet përfundimtare të nxënësve. Ai përdoret për të përcaktuar se sa mirë i kanë përvetësuar nxënësit njohuritë dhe aftësitë e kërkuara nga programet lëndore.

Qëllimet e vlerësimit të të nxënit janë:

- Përcakton nivelin e njohurive dhe të aftësive të fituara nga nxënësit pas një grupi orësh mësimore, një periudhe, një viti shkollor ose një niveli arsimor.
- Përdoret për të vënë nota ose vlerësime që reflektojnë performancën e nxënësve.
- Ndihmon mësuesit dhe institucionet arsimore të analizojnë dhe të përmirësojnë metodat e tyre pedagogjike.
- Shërben si bazë për të përcaktuar nëse një nxënës është i gatshëm të kalojë në një nivel më të lartë arsimor.
- Siguron të dhëna të qarta për arritjet mësimore të nxënësve për prindërit, stafin mësimor dhe politikëbërësit.

Më poshtë jepen disa teknika të vlerësimit të të nxënit:

- Kontroll njohurish dhe aftësish nga mësuesi (teste në fund të periudhës).
- Prezantime projektesh ku demonstrohen njohuritë e fituara nga nxënësit përgjatë një periudhe në një lëndë të caktuar.
- Testime të standardizuara kombëtare apo ndërkombëtare.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë dallimet mes vlerësimit për të nxënë dhe vlerësimit të të nxënit.

Vlerësimi për të nxënë	Vlerësimi i të nxënit
Realizohet gjatë gjithë procesit të mësimdhënies.	Realizohet në fund të një grupi orësh, të një kapitulli, të një periudhe mësimore ose të një niveli arsimor.
Ofrohen reagime dhe komente për përmirësim.	Ka për qëllim vendosjen e notave ose të një vlerësimi përfundimtar.
Përqendrohet në zhvillimin dhe në përmirësimin e nxënësve.	Përqendrohet në matjen e performancës së nxënësve.

Përdoret për të përshtatur ose për të përmirësuar qasjet, metodat dhe teknikat mësimore.	Përdoret për të marrë vendime në lidhje me nivelin e njohurive ose të aftësive të nxënësve.
--	---

c) *Vlerësimi diagnostikues*

Vlerësimi diagnostikues është një lloj vlerësimi që bëhet në fillim të një procesi mësimor (niveli arsimor, viti shkollor, kapitulli, orësh mësimore) me qëllim që mësuesi të kuptojë nivelin e njohurive, aftësive dhe nevojave të nxënësve. Ai e ndihmon mësuesin të përshtatë metodat dhe teknikat e tij mësimore për të mbështetur më mirë nxënësit.

Qëllimet e vlerësimit diagnostikues janë:

- *Identifikimi i njohurive dhe i aftësive ekzistuese të nxënësve:* Me anë të këtij vlerësimi përcaktohet se çfarë dinë nxënësit mbi një temë/grup temash të caktuara.
- *Zbulimi i dobësive në të nxënë:* Ky vlerësim i krijon mundësi mësuesit të identifikojë vështirësitë që mund të kenë nxënësit nga vitet/kapitujt/orët e mëparshme.

Më poshtë jepen disa instrumente të vlerësimit diagnostikues:

- Një test i shkurtër për të parë njohuritë dhe aftësitë kryesore të nxënësve në një lëndë ose në një grup temash mësimore.
- Pyetje të hapura për të parë sa kanë përvetësuar nxënësit njohuri dhe aftësi të caktuara ose sa janë të familjarizuar me to.

Karakteristikat kryesore të vlerësimit diagnostikues:

- Nuk përdoret për të vlerësuar nxënësit me notë. Rezultatet e këtij vlerësimi nuk ndikojnë në vlerësimin përfundimtar të nxënësit.
- Përdoret për të përmirësuar mësimdhënien. Mësuesi e përdor për të identifikuar nivelin e nxënësve dhe për të ndërtuar punën e tyre në të ardhmen.
- Ndihmon në krijimin e planeve të personalizuara të të nxënësit dhe për të ndërtuar punë të diferencuar me nxënësit.

ç) *Vetëvlerësimi*

Vetëvlerësimi është një proces në të cilin nxënësit reflektojnë për përparimin e tyre në të nxënë, vlerësojnë punën e tyre dhe identifikojnë pikat e forta dhe fushat ku kanë nevojë për përmirësim. Ky lloj vlerësimi ndihmon në zhvillimin e autonomisë dhe të përgjegjësisë për të nxënit.

Qëllimet e vetëvlerësimit janë:

- Ndihmon nxënësit të kuptojnë se si mësojnë dhe çfarë duhet të përmirësojnë. Gjithashtu, ky vlerësim rrit ndërgjegjësimin e nxënësve për të nxënë.
- I nxit nxënësit të analizojnë punën e tyre, të reflektojnë dhe të marrin vendime për përmirësim.
- Rrit motivimin dhe përgjegjësinë e nxënësve. Duke vlerësuar progresin e tyre, nxënësit ndihen më të angazhuar dhe më të motivuar për të arritur rezultate më të mira.
- Ndihmon në vendosjen e qëllimeve personale. Nxënësit mund të përcaktojnë qëllime të qarta dhe të punojnë për t'i arritur ato.
- Përmirëson vetëbesimin e nxënësve, i ndihmon ata të kuptojnë se janë të aftë të përmirësohen dhe të zhvillojnë një qasje më pozitive ndaj të nxënit.

Më poshtë jepen disa teknika të vetëvlerësimit:

- Fletë reflektimi, ku nxënësit u përgjigjen pyetjeve, si: *Çfarë kam mësuar? Çfarë më ka ndihmuar më shumë? Çfarë mund të bëj më mirë?*
- Vetëvlerësimi duke përdorur rubrika, ku nxënësit vlerësojnë punën e tyre sipas kriterëve të përcaktuara.
- Ditarët e të nxënit, ku nxënësit mund të mbajnë shënime për arritjet dhe pikat e dobëta të tyre gjatë procesit mësimor.
- Vetëvlerësimi me shkallë vlerësimi, i cili u jep mundësi nxënësve të vlerësojnë veten duke përdorur shkallë nga 1 në 5, ose nga “Jo mirë” në “Shumë mirë”.
- Krahasimi i një detyre të mëparshme me një të re, për të parë përmirësimet dhe ndryshimet.
- Etj.

d) Vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri

Vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri ose vlerësimi mes bashkëmoshatarëve është një proces në të cilin nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit duke u bazuar në kritere të qarta dhe objektive.

Qëllimet e këtij vlerësim janë:

- Nxënësit zhvillojnë aftësitë e të menduarit në mënyrë kritike. Ata mësojnë të analizojnë dhe të japin komente konstruktive për punën e tjetrit.
- U krijon mundësi nxënësve të ndihmojnë dhe të mbështesin njëri-tjetrin në procesin e të nxënës.
- Nxënësit bëhen më të vetëdijshëm për cilësinë e punës dhe për mënyrat se si mund të përmirësojnë punën e tyre.
- Nxënësit ndihen më të përfshirë dhe më të përgjegjshëm për cilësinë e mësimit të tyre.

Disa teknika ose instrumente të vlerësimit të nxënësve nga njëri-tjetri janë:

- *Dy pozitive dhe një sugjerim:* Nxënësit identifikojnë dy gjëra që janë bërë mirë dhe një aspekt që mund të përmirësohet nga tjetri.
- *Rubrikë vlerësimi:* Nxënësit përdorin një rubrikë të përgatitur nga mësuesi për të vlerësuar punën e shokëve të tyre.
- *Shkrimi i komenteve:* Nxënësit shkruajnë komente për punën e njëri-tjetrit duke përdorur pyetje, si: *Çfarë funksionon mirë? Çfarë mund të përmirësohet? Çfarë sugjerimesh keni?*
- *Diskutimi në grupe të vogla:* Nxënësit ndajnë punën e tyre dhe komentojnë për punët e njëri-tjetrit në një mjedis bashkëpunues.

dh) Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara

Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara duhet të sigurojë që ata të kenë mundësinë të shprehin njohuritë dhe aftësitë e tyre në përmbushje të rezultateve të të nxënës të planeve edukative individuale (PEI). Për këtë arsye, mësuesi duhet të përshtatë detyrat dhe veprimtaritë vlerësuese sipas mundësive dhe nevojave individuale të këtyre nxënësve.

Këto përshtatje mund të përfshijnë:

- Ndryshimin e formateve të pyetjeve dhe të përgjigjeve si, për shembull, ofrimin e një versioni të thjeshtuar të një pyetjeje (bazuar në pika kryesore) në vend të një kërkesë të gjatë.

- Modifikimin e veprimtarive vlerësuese, duke thjeshtuar gjuhën e përdorur ose duke ndryshuar formatin e pyetjeve për t'iu përshtatur më mirë aftësive të nxënësit.
- Përshtatjen e procesit të vlerësimit, si: dhënien e kohës shtesë, ofrimin e pushimeve të ndërmjetme apo përdorimin e teknologjive ndihmëse.
- Përshtatjen e udhëzimeve, duke i bërë ato më të qarta dhe të personalizuar për nxënës me vështirësi në komunikim ose me nevoja të tjera specifike.

Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për këta nxënës duhet të diskutohen në mënyrë të rregullt me prindërit dhe mësuesit ndihmës, duke siguruar që ata të jenë të informuar për ndikimin e këtyre përshtatjeve në procesin e vlerësimit dhe në përparimin e nxënësve.

7.3. Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënësit

Në këtë pjesë jepen *dy shembuj orientues* të niveleve të arritjes për dy rezultate të nxënësit, me qëllim që të ofrohet një ide e përgjithshme për mënyrën e përshkallëzimit të arritjeve të nxënësve. Këta shembuj mund të shërbejnë si pikënisje për mësuesin në ndërtimin e kritereve të vlerësimit të nxënësve.

Shembull 1. Rezultati i të nxënësit: Nxënësi analizon ilustrimet dhe tregon se si kontribuojnë ato në kuptimin e përrallës.			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
Nxënësi analizon në mënyrë të plotë ilustrimet dhe shpjegon qartë se si ato pasqyrojnë dhe thellojnë të kuptuarit e përrallës.	Nxënësi analizon mirë ilustrimet tregon se ato lidhen me përmbajtjen e përrallës dhe ndihmojnë në kuptimin e saj.	Nxënësi përshkruan ilustrimet, por i lidh pjesërisht me kuptimin e përrallës.	Nxënësi përshkruan ilustrimet pa treguar lidhjen e tyre me kuptimin e përrallës.
Shembull 2. Rezultati i të nxënësit: Nxënësi shpjegon se si në tekstin që ka shkruar, mesazhi mund të kuptohet ndryshe nga lexues me këndvështrime të ndryshme.			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët

Nxënësi shpjegon qartë dhe me shembuj se si mesazhi i tekstit mund të interpretohet ndryshe nga lexues me këndvështrime të ndryshme.	Nxënësi tregon se mesazhi i tekstit mund të kuptohet ndryshe nga lexues të ndryshëm dhe jep një shpjegim të pranueshëm.	Nxënësi përmend se mund të ketë këndvështrime të ndryshme, por nuk e shpjegon qartë ndikimin e tyre në kuptimin e mesazhit.	Nxënësi nuk arrin të shpjegojë se si mesazhi i tekstit mund të interpretohet ndryshe nga lexues të ndryshëm.
--	---	---	--

Shënim. Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjuhës shqipe do të përshkruhen nivelet e arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënëit.

VIII. BURIMET DHE MATERIALET MËSIMORE

Burimet dhe materialet mësimore janë të gjitha mjetet që përdoren në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënëit për të mbështetur përvetësimin e kompetencave gjuhësore dhe të kompetencave kyç. Ato përfshijnë si burime të shtypura dhe digjitale, ashtu edhe mjete pamore, dëgjimore dhe praktike, të cilat ndihmojnë në përmbushjen e rezultateve të të nxënëit dhe në aktivizimin e nxënësve në mënyrë të kuptimshme e të angazhuar.

Dobitë kryesore të burimeve të të nxënëit janë:

- Pasurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe nxitja e nxënësve për të mësuar.
- Lehtësimi i procesit të të kuptuarit të njohurive dhe të koncepteve gjuhësore ose i procesit të përmbushjes së rezultateve të të nxënëit.
- Sigurimi i qartësisë dhe i saktësisë në paraqitjen dhe përpunimin e informacionit.
- Nxitja e angazhimit aktiv të nxënësve në të katër aspektet e gjuhës: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.
- Mbështetja e mësimi gjithëpërfshirës dhe të personalizuar, duke respektuar nevojat dhe stilet e ndryshme të të nxënëit.
- Sigurimi i ruajtjes dhe i transferimit të njohurive dhe të aftësive gjuhësore.

Burimet dhe materialet mësimore që mund të përdoren në lëndën e gjuhës shqipe, janë:

- Teksti shkollor (së bashku me fletoren e punës), i cili është një nga materialet mësimore që mund të përdoren në orën e mësimi.
- Tekste të tjera letrare dhe joletrare në bibliotekën e shkollës (përralla, tregime, poezi, letra, lajme, dialogë, ese, artikuj etj.).

- Fjalorë dhe udhëzues gramatikorë dhe drejtshkrimorë (kryesisht online).
- Burime digjitale: platforma interaktive, video edukative, regjistrime zanore, faqe interneti për lexim dhe shkrim, aplikacione gjuhësore etj.
- Materiale të krijuara nga mësuesi: fletë pune, kartela gjuhësore, ushtrime për diktimit ose redaktim, pjesë për përpunim, pyetësorë, modele tekstesh etj.
- Punime të nxënësve, si p.sh.: ditarë leximi, punë me shkrim, postera (afishe), prezantime etj.
- Mjete pamore: tabela për strukturën e tekstit ose për klasat e fjalëve, ilustrime, skema, diagrame, grafikë etj.

Mësuesi zgjedh burimet dhe materialet në varësi:

- të rezultateve të të nxënësve që synon të përmbushë,
- të mjedisit të klasës dhe veçorive të nxënësve,
- të përmbajtjes tematike dhe llojit të tekstit që punohet.
- të nevojës për larmi, ndihmë vizuale ose gjuhësore, ose për zgjidhje praktike.

8.1. Përdorimi i teknologjisë në lëndën e gjuhës shqipe

Përdorimi i teknologjisë në lëndën e gjuhës shqipe shërben si mjet mbështetës dhe nxitës për të përmirësuar cilësinë e të nxënësve, për të rritur motivimin e nxënësve dhe për të zgjeruar burimet e të mësuarit përtej tekstit shkollor tradicional. Teknologjia ndihmon në zhvillimin e kompetencave gjuhësore përmes mjeteve interaktive, mjediseve bashkëpunuese dhe formave të reja të krijimit dhe të përpunimit të teksteve. Disa nga format e përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor janë:

- Përdorimi i platformave digjitale për lexim dhe ushtrime gjuhësore (fjalëkryqe interaktive, kuize (pyetje të shpejta), redaktime online).
- Krijimi i prezantimeve me *PowerPoint*, *Canva* ose mjete të tjera ngjashme.
- Realizimi i projekteve kurrikulare ose ndërkurrikulare me përdorimin e teknologjisë.

- Leximi online, ku nxënësit lexojnë një tekst digjital, bëjnë një përmbledhje dhe e ndajnë përmes *blog*-ut të klasës ose forumeve digjitale.
 - Dëgjimi i teksteve audio dhe shikimi i materialeve video për zhvillimin e të kuptuarit të dëgjimit dhe të të folurit.
 - Përdorimi i mjeteve për bashkëpunim në kohë reale (p.sh.: *Google Docs*, *Padlet* etj.) për të ndarë ide, për të redaktuar tekste në grup dhe për të diskutuar nxënësit me njëri-tjetrin.
 - Kërkimi në internet për burime të përshtatshme letrare ose informative, duke mësuar njëkohësisht si të vlerësohen dhe si të citohen burimet.
- Mësuesi udhëzon përdorimin e teknologjisë jo si qëllim në vetvete, por si mjet për zhvillimin e kompetencave të lëndës. Ai kujdeset që përdorimi i saj të jetë i qëllimshëm, i sigurt dhe në përputhje me moshën dhe nivelin e nxënësve, duke ndërtuar një kulturë digjitale etike dhe të përgjegjshme. Në këtë proces, mësuesi nxit qasjen kritike dhe krijuese të nxënësve ndaj burimeve online dhe i udhëzon ata të përdorin teknologjinë për të ndërtuar kuptim, për të komunikuar në mënyrë të efektshme dhe për të bashkëpunuar me të tjerët në mjedise të sigurta digjitale.

8.2. Roli i bibliotekës së shkollës

Biblioteka e shkollës ndihmon në ndërtimin dhe zhvillimin e njohurive të nxënësve, duke mbështetur të nxënit gjatë gjithë jetës. Ajo mbështet suksesin e nxënësve në të gjitha lëndët e kurrikulës, veçanërisht në lëndën e gjuhës shqipe, duke i inkurajuar ata të lexojnë me pasion, të mësojnë të analizojnë dhe të interpretojnë tekste të ndryshme për të kuptuar dhe për të shijuar përmbajtjen, si dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre kërkimore dhe të përdorin në mënyrë efektive informacionin e mbledhur.

Biblioteka e shkollës u mundëson nxënësve:

- të zhvillojnë dashurinë për leximin, si për qëllime mësimore, ashtu edhe për kënaqësi;
- të zhvillojnë aftësi lexim-shkrimi duke përdorur tekste letrare dhe joletrare;
- të zhvillojnë aftësitë për të qenë lexues të pavarur dhe për të menduar në mënyrë kritike;
- të kenë qasje në programe, burime dhe teknologji të integruara që mbështesin të gjitha lëndët e kurrikulës;
- të kuptojnë dhe të vlerësojnë rolin e bibliotekës si burim për të mësuar gjatë gjithë jetës.

Mësuesi i bibliotekës duhet të bashkëpunojë me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të lëndëve të ndryshme për të hartuar detyra autentike dhe për t'ua ofruar ato nxënësve që të zhvillojnë aftësitë për:

- qasjen, përzgjedhjen, mbledhjen, përpunimin, vlerësimin kritik, krijimin dhe komunikimin e informacionit;
- përdorimin e informacionit për të eksploruar dhe për të hetuar çështje, për të zgjidhur probleme, për të marrë vendime, për të ndërtuar njohuri dhe për të pasuruar jetën e tyre;
- komunikimin e gjetjeve të tyre për audiencë të ndryshme, duke përdorur formate dhe teknologji të ndryshme;
- përdorimin e informacionit dhe të kërkimeve në mënyrë të përgjegjshme.

Për më tepër, mësuesi i bibliotekës mund të bashkëpunojë me mësuesit e gjuhës shqipe për të ndihmuar nxënësit:

- të zhvillojnë aftësi digjitale për përdorimin e formave, si rrjetet sociale dhe *blogjet*, duke mësuar mënyrat më të mira për të siguruar informacion të besueshëm dhe të rëndësishëm;
- të hartojnë pyetje kërkimore për projektet e tyre;
- të krijojnë dhe të bëjnë prezantime me media ose me shumë media.

Mësuesit duhet të diskutojnë me nxënësit konceptin e pronësisë dhe rëndësinë e të drejtave të autorit në të gjitha format e mediave.


Shënim. Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjuhësor do të përshkruhet më hollësisht përdorimi i burimeve dhe i materialeve mësimore përfshirë teknologjinë.

IX. REKOMANDIME PËR ZBATUESIT E PROGRAMIT

Programi i gjuhës shqipe bazohet në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, në kurrikulën bërthamë, në planin mësimor të arsimit bazë, si dhe në rekomandimet më të fundit të Bashkimit Europian për arsimin. Si i tillë, ky dokument u shërben mësuesve të gjuhës shqipe, autorëve të teksteve shkollore, hartuesve të testeve kombëtare, prindërve dhe vetë nxënësve si një udhëzues për përmbajtjen, organizimin dhe zhvillimin e

procesit mësimor.

Kjo rubrikë përmban disa rekomandime praktike për zbatuesit e programit, me synimin që të sigurohet efektiviteti i zbatimit të tij dhe të sigurohet që të gjitha palët e përfshira të kontribuojnë në përmbushjen e qëllimeve të lëndës së gjuhës shqipe, duke nxitur përdorimin e metodave bashkëkohore, përzgjedhjen e materialeve të përshtatshme, zhvillimin e kompetencave gjuhësore dhe përfshirjen aktive të nxënësve në procesin mësimor.



Rekomandime për mësuesit

- Planifikoni mësimin duke marrë parasysh ritmet dhe nevojat individuale të nxënësve, përfshirë ata me nevoja të veçanta dhe me prirje të veçanta gjuhësore e krijuese.
- Krijoni mundësi që nxënësit të zhvillojnë aftësitë bazë gjuhësore, përfshirë njohjen e shkronjave, shqiptimin, ndarjen në rrokje, dekodimin dhe rrjedhshmërinë. Këto aftësi janë të rëndësishme për të ngushtuar boshllëqet në mundësitë për të nxënë.
- Punoni çdo orë mësimi për zhvillimin e kompetencave të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit përmes situatave të jetës reale dhe punës me tekste autentike e funksionale.
- Integroni njohuritë dhe aftësitë e gjuhës shqipe me fusha të tjera të nxënësve, kryesisht me gjuhët e huaja, për nxënie holistike dhe për arsye që njohuritë dhe aftësitë gjuhësore janë të transferueshme.
- Zhvilloni te nxënësit dashurinë për leximin duke përzgjedhur vepra letrare dhe joletrare me cilësi të lartë, duke lexuar me zë në klasë, duke krijuar mundësi të vazhdueshme dhe motivim për lexim të pavarur në shkollë dhe jashtë saj.
- Krijoni mundësi që nxënësit të lexojnë një përzgjedhje të larmishme tekstesh autentike nga gjini, kultura dhe periudha të ndryshme.

- Përdorni metoda të ndryshme mësimore, kryesisht të nxënimit aktiv, bashkëpunues dhe të personalizuar, që marrin parasysh nevojat, ritmet dhe stilet e të nxënimit të çdo nxënësi.
- Krijoni hapësira dhe mundësi të shpeshta që nxënësit të diskutojnë dhe të shkruajnë rreth teksteve që lexojnë, në mënyrë që të zhvillojnë mendimin kritik.
- Kujtoni që leximi i teksteve cilësore nga nxënësit është themel për zhvillimin e aftësive të shkrimit efektiv.
- Krijoni mundësi që nxënësit të ekspozohen ndaj teksteve të ndërlikuara dhe sfiduese në nivelin e klasës dhe më lart, me mbështetje të përshtatshme, në funksion të pritshmërive të larta për të gjithë nxënësit.
- Mbani në konsideratë gjatë punës suaj faktin që zhvillimi i aftësisë për të shkruar kërkon praktikë të rregullt në forma dhe gjini të ndryshme, mundësi për t'iu drejtuar lexuesve të ndryshëm dhe udhëzime të vazhdueshme për fjalorin dhe përdorimin e rregullave të gjuhës standarde.
- Siguroni mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe përfshirje në të gjitha veprimtaritë gjuhësore, për të gjithë nxënësit, përfshirë ata të pakicave kombëtare dhe të grupeve në nevojë.
- Përdorni tekste të ndryshme letrare dhe jolettrare, të përshtatshme për moshën, interesat dhe nivelin e klasës, që nxisin të menduarit kritik dhe krijues.
- Jepuni nxënësve mundësi të shumta për të komunikuar, për të diskutuar, për të shprehur mendimin dhe për të reflektuar për përvojat e tyre përmes gjuhës.
- Punoni me nxënësit për të ndërtuar njohuri mbi funksionimin e sistemit gjuhësor të shqipes (gramatikë, drejtshkrim, fjalëformim, leksik) të lidhura me përdorimin praktik të gjuhës.
- Përdorni vlerësimin formues dhe vlerësimin në proces (në projekte, në punë me shkrim) në mënyrë të vazhdueshme për të ndjekur përparimin e nxënësve, për t'i udhëzuar drejt përmirësimit dhe për të reflektuar mbi mësimdhënien.
- Përdorni platforma digjitale interaktive dhe mjete teknologjike për të mbështetur zhvillimin e kompetencave gjuhësore.
- Krijoni një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të inkurajuar për të shprehur mendimet e tyre lirshëm.

- Konsiderojini prindërit si partnerë të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive të nxënësve për të lexuar, për të shkruar, për të folur dhe për të dëgjuar.
- Zbatoni gjatë procesit mësimor qasjen socio-emocionale, e cila mund të përmirësojë rezultatet e të nxënit, qëndrimet dhe sjelljet, si dhe të zvogëlojë shqetësimet emocionale. Nxënësit duhet të mësojnë të njohin veten nëpërmjet teksteve (vetëdije), të përballen me vështirësitë që sjellin tekstet sfiduese (vetëmenaxhim), të përshtatin gjuhën sipas audiencës dhe qëllimit (ndërgjegjësim social), të reflektojnë për zgjedhjet e personazheve (vendimmarrje e përgjegjshme), të bashkëpunojnë me respekt me bashkëmoshatarët (aftësi ndërpersonale).
- Përzgjidhni tekste letrare dhe joletrare që ushqejnë vlerësimin për artin, bukurinë dhe të vërtetën, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë më mirë përvojën njerëzore nga këndvështrime të ndryshme. Leximi, diskutimi dhe shkrimi i prozës dhe i poezisë cilësore i ndihmon nxënësit të zhvillojnë empatinë, ndjenjën e vlerave të përbashkëta të trashëgimisë letrare, si dhe të formësojnë një mendim të pavarur, të thelluar dhe kritik për veten dhe botën.
- Konsultoni dhe zbatoni udhëzuesit kurrikularë të lëndës së gjuhës shqipe, në përputhje dhe me nevojat e klasës suaj.

Rekomandime për autorët e teksteve shkollore

- Përshtatni tekstet shkollore të gjuhës shqipe në përputhje me përditësimet më të fundit të kurrikulës dhe me zhvillimet bashkëkohore në fushën e arsimit.
- Përfshini burime digjitale që mbështesin të dëgjuarit, të folurit, leximin, shkrimin dhe njohuritë e aftësitë për sistemin gjuhësor të shqipes.
- Siguroni libra për mësuesin, me udhëzime pedagogjike dhe me sugjerime për planifikim, vlerësim dhe zbatime të qasjes me në qendër nxënësin.
- Përfshini materiale burimore të larmishme, tekste letrare e joletrare, burime digjitale, punë të nxënësve, modele shkrimi etj., që ndihmojnë në realizimin e qëllimeve të lëndës.
- Zbatoni në mënyrë të balancuar raportet e rekomanduara (siç janë dhënë të të lexuarit), ndërmjet teksteve letrare dhe joletrare, letërsisë shqipe dhe botërore, si dhe ndërmjet gjinive dhe llojeve (prozë, poezi, dramë), duke siguruar që përzgjedhja e teksteve të jetë në funksion të rezultateve të të nxënit, nivelit të klasës dhe zhvillimit të kompetencave.

- Integroni njohuritë gjuhësore dhe përmbajtjet letrare me fusha e lëndë të tjera dhe me situata nga jeta reale, për të nxitur të menduarit holistik dhe ndërdisiplinor.
- Përfshini në tekstet shkollore dhe në fletoret e punës, pyetje dhe ushtrime që nxisin mendimin kritik, interpretimin e tekstit, krijimtarinë letrare etj., në përputhje me qasjen për kompetenca.
- Krijoni mundësi në tekstet shkollore për përmbajtje që ndërtojnë aftësitë për të komunikuar në mënyrë të qartë dhe të ndërgjegjshme, si dhe që ndihmojnë nxënësit të kuptojnë rolin e gjuhës në formimin personal, qytetar dhe profesional.
- Siguroni që tekstet të jenë gjithëpërfshirëse, të përshtatshme për moshën dhe të ndjeshme ndaj diversitetit kulturor e gjuhësor dhe aftësive të ndryshme të nxënësve.

Rekomandime për hartuesit e testeve kombëtare

- Siguroni që testet të përmbajnë jo vetëm pyetje për njohuritë gjuhësore dhe gramatikore, por edhe detyra që kërkojnë zbatim funksional të gjuhës në situata reale komunikimi.
- Përfshini pyetje dhe kërkesa që vlerësojnë të menduarit kritik, aftësinë për të interpretuar e për të përpunuar informacionin, si dhe krijimtarinë në përdorimin e gjuhës.
- Hartoni pyetje dhe teste që mundësojnë ndërthurjen e gjuhës shqipe me letërsinë.
- Merrni parasysh diversitetin kulturor, gjuhësor dhe socio-ekonomik të nxënësve, duke përdorur tekste dhe formulime të qarta, të kuptueshme dhe gjithëpërfshirëse.
- Respektoni balancën mes njohurive për sistemin gjuhësor dhe aftësive komunikuese, duke vlerësuar si njohuritë teorike, ashtu edhe aftësinë për të lexuar, për të shkruar, për të folur dhe për të dëgjuar në mënyrë të ndërgjegjshme.
- Hartoni modele testesh orientuese që të mund të përdoren nga mësuesit gjatë viteve të shkollimit për të ndihmuar nxënësit të përgatiten në mënyrë të përshkallëzuar dhe të natyrshme për vlerësimin përfundimtar.

Rekomandime për prindërit

- Inkurajoni fëmijët të kuptojnë rëndësinë e gjuhës shqipe jo vetëm për qëllime mësimore, por dhe si një mjet për të shprehur veten, për të ndërtuar marrëdhënie dhe për të kuptuar botën.
- Lexoni rregullisht me fëmijët dhe diskutoni për libra, tregime apo tema që nxisin të menduarit, ndjenjat dhe imagjinatën.
- Promovoni një qëndrim pozitiv ndaj të nxënit të gjuhës, duke theksuar rëndësinë e përpjekjes, këmbënguljes dhe mësimit nga gabimet.
- Bashkëpunoni me mësuesit për të ndihmuar fëmijët në projekte ose veprimtari që lidhen me gjuhën dhe letërsinë.
- Njihuni me qëllimet e lëndës dhe me pritshmëritë e programit në mënyrë që të ndihmoni ose të mbështetni fëmijët tuaj në procesin e të nxënit.
- Siguroni që fëmijët ndihen të mbështetur dhe të motivuar, duke krijuar një mjedis të qetë dhe të pasur me gjuhë në shtëpi, ku leximi, të folurit dhe dëgjimi vlerësohen dhe nxiten.

Rekomandime për nxënësit

- Merrni pjesë aktive në orët e gjuhës shqipe, duke folur, shkruar e lexuar me kuptim dhe duke ndarë mendime për temat që trajtohen.
- Përfshihuni në projekte kurrikulare që lidhen me gjuhën shqipe dhe me kulturën shqiptare, duke përdorur tekstin si mjet për të shprehur veten dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
- Bashkëpunoni me shokët e klasës për të krijuar tekste të përbashkëta, për të diskutuar idetë dhe për të reflektuar për përmbajtjen e teksteve që lexoni.
- Jini kureshtarë, pyesni kur nuk kuptoni dhe kërkoni ndihmë për të përmirësuar shkrimin, të folurit apo të kuptuarit e tekstit.
- Përdorni mjete digjitale dhe burime online për të ushtruar gjuhën dhe për të eksploruar tekste të reja në mënyrë të pavarur.
- Vlerësoni rëndësinë e gjuhës shqipe si mjet komunikimi, si pjesë e identitetit tuaj kombëtar dhe si pasuri që do t'ju ndihmojë në çdo fushë të jetës dhe në të ardhmen profesionale.

X. NDRYSHIMET PËRMBAJTJESORE

Krahasuar me programin e mëparshëm të gjuhës shqipe për klasën e gjashtë, në këtë program:

- Kanë ndryshuar kompetencat kyç, në përputhje me risitë e Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar. Këto kompetenca janë:
 - ✓ Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare
 - ✓ Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
 - ✓ Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri
 - ✓ Kompetenca digjitale
 - ✓ Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit
 - ✓ Kompetenca qytetare
 - ✓ Kompetenca e sipërmarrjes
 - ✓ Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç tashmë janë përcaktuar për secilën klasë (dhe jo më për shkallë).
- Janë ndryshuar temat ndërkurrikulare, për të cilat programi ofron disa shembuj se si mund të trajtohen në lëndën e gjuhës shqipe. Temat ndërkurrikulare janë:
 - ✓ Identiteti kombëtar
 - ✓ Qytetaria aktive dhe sipërmarrja
 - ✓ Shëndeti mendor e fizik dhe siguria
 - ✓ Zhvillimi i qëndrueshëm
 - ✓ Teknologjia, shoqëria dhe media
- Kanë ndryshuar kompetencat e lëndës:
 - ✓ Të dëgjuarit dhe të folurit janë bashkuar në një kompetencë të vetme, “Të dëgjuarit dhe të folurit për qëllime të ndryshme”, pasi këto ndodhin së bashku në situatat e komunikimit; nuk mund të ketë dialog, debat apo diskutim efektiv pa dëgjim aktiv dhe reagim përmes të folurit. Të dyja janë pjesë e komunikimit gojor.

- ✓ Të shkruarit për qëllime të ndryshme është riemërtuar në “Krijimi i teksteve të ndryshme”, për të vënë më shumë theks mbi procesin e plotë krijues, që nis nga konceptimi i idesë, planifikimi, përzgjedhja e formës, përdorimi i mjeteve gjuhësore e stilistike, deri tek rishikimi, redaktimi dhe prezantimi përfundimtar.
- ✓ Në ndarjen e kohës mësimore, janë sugjeruar 25 orë që mësuesi t’i përdorë për projekt, përsëritje, teste, biseda letrare ose lexime jashtë klase. Kjo i jep më shumë fleksibilitet në planifikim, duke e bërë programin më të zbatueshëm dhe më të përshtatur me nevojat e nxënësve.
- Janë shtuar te të dëgjuarit:
 - ✓ qëllimet dhe strategjitë bazë të të dëgjuarit;
 - ✓ dallimi midis faktit dhe opinionit;
 - ✓ roli i zërit dhe i gjuhës së trupit në kuptimin e mesazhit, vlerësimi kritik i tekstit të dëgjuar;
 - ✓ tekstet digjitale (podcast, video shpjeguese, reklama digjitale, fushata ndërgjegjësimi).
- Janë shtuar te të folurit:
 - ✓ Qëllimet e të folurit: Zgjedhja e fjalëve dhe përdorimi i gjuhës së qartë ose të kuptueshme.
 - ✓ Elementet e komunikimit joverbal.
 - ✓ Përdorimi i elementeve pamore të thjeshta (postera, vizatime, imazhe, skema të thjeshta).
- Janë hequr te të folurit:
 - ✓ Vlerësimi i ideve dhe i opinioneve të të tjerëve gjatë një diskutimi.
 - ✓ Komunikimi me të rriturit dhe bashkëmoshatarët (ndryshimet në komunikim).
- Janë shtuar te të lexuarit tekstet digjitale, si: artikuj të thjeshtë online për fëmijë (nga faqe edukative ose revista online), përmbledhje lajmesh për fëmijë (në formë teksti ose të shoqëruar me video).
- Programi përcakton një raport të balancuar midis letërsisë shqipe dhe letërsisë botërore. Tekstet nga autorë shqiptarë synojnë të forcojnë identitetin gjuhësor dhe kombëtar, ndërsa tekstet nga autorë të letërsisë botërore u ofrojnë nxënësve njohjen e temave universale dhe zgjerimin e horizonteve kulturore.

- Janë përfshirë të detajuara strategjitë e të kuptuarit: para, gjatë dhe pas leximit.
- Janë hequr të shkruarit: njoftime, artikuj për gazeta, letra, urime për festa. Janë sugjeruar disa tema për punë me shkrim.
- Në morfologji janë shtuar emrat e përveçëm dhe të përgjithshëm; janë specifikuar njohuritë për përemrat (*Përemri dëftor. Kategoritë gramatikore të përemrit dëftor (gjini, numër dhe rasë) Përemri pyetës i ndryshueshëm dhe i pandryshueshëm. Kategoritë gramatikore të përemrit pyetës (gjini, numër dhe rasë)*); janë shtuar foljet ndihmëse.
- Është hequr ndajshimi.
- Janë hequr njohuritë dhe aftësitë që kanë lidhje me fonetikën dhe fonologjinë.
- Është rritur niveli i aftësive rreth sistemit gjuhësor të shqipes (nxënësi përdor, gjykon, argumenton, vlerëson).
- Janë sugjeruar veprimtari për përmbushjen e rezultateve të të nxënit, si dhe janë dhënë shembuj të niveleve të arritjes së rezultateve të të nxënit.